



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Nëntor 2021/ Nr. 11



Peleshi: "Defender 2021", histori sukcesi
Shqipëria, gati të shërbejë
sërish si vend pritës i stërvitjes
më të madhe "Defender 23"



AFA
Shqipëria organizon
Kursin e Lartë për Studimet
e Sigurisë dhe Mbrojtjes



Muaji i ndërgjegjësimit
Tetori rozë, zëvendësministria
e Mbrojtjes: Mos hezitoni, pa
gruan nuk ka jetë!



MINISTERIALI I MBROJTJES NË BRUKSEL

**Peleshi: FA-të angazhohen për sigurinë e kampit
ku janë strehuar refugjatët afganë në Kosovë**

Përmbajtja

Numri 11

BASHKËPUNIMI

- 6** Peleshi, homologëve të NATO-s: Kosova nuk është as çerek shteti, as gjysmë shteti, por shtet në kuptimin e plotë të fjalës

AFA

- 9** Shqipëria organizon Kursin e Lartë për Studimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes

VIZITA

- 11** Gjeneral Caravaca: Do të vijojmë kryerjen me përkushtim të misionit, për të qenë në lartësinë e sfidave me të cilat përballet NATO

FUQIZIMI I ROLIT TË GRUAS

- 18** Vajzat dhe gratë në politikën e sigurisë, zv/ministrja e Mbrojtjes: Kemi rritur përfaqësimin e tyre në FA

AKADEMIA E FORCËVE TË ARMATOSURAS

- 28** Programi Ekstra-Kurrikular, risi për studentët e Bachelor-it

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 MINISTERIALI

Peleshi: FA-të angazhohen për sigurinë e kampit ku janë strehuar refugjatët afganë në Kosovë

Mbrojtja e vendeve të NATO-s dhe lufta kundër terrorizmit në Afganistan dhe Irak ishin temat kryesore të ditës së pare të takimit të ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës...



8 "DEFENDER 2021"

Shqipëria, gati të shërbejë sërish si vend pritës i stërvitjes më të madhe "Defender 23"

Shqipëria ka nisur punën për të pritur sërish një nga stërvitjet më të mëdha "Defender 2023". Për këtë u organizua edhe konferenca koordinuese...



16 MUAJI I NDËRGJEGJËSIMIT

Tetori rozë, zëvendësministrja e Mbrojtjes: Mos hezitoni, pa gruan nuk ka jetë!

Dreitoje Timonin nga Shëndeti Yt! Tetori Rozë si muaji i ndërgjegjësimit global për të rritur ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit. Vetëkontrolli mujor dhe ekzaminimi nga personeli...



24 ROLI I ARSIMIMIT TË USHTARAKËVE

Lidershipi Shqiptar dhe roli i tij në ushtri

Si një studiuë e konceptit të lidhshpimit ushtarak dhe rolit të tij në periudha të ndryshme kohore. Sa e rëndësishme ishte prania e ushtarakëve të huaj në strukturat e Forcave...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 11/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>





MINISTERIALI I MBROJTJES NË BRUKSEL

Peleshi: FA-të angazhohen për sigurinë e kampit ku janë strehuar refugjatët afganë në Kosovë

Mbrojtja e vendeve të NATO-s dhe lufta kundër terrorizmit në Afganistan dhe Irak ishin temat kryesore të ditës së pare të takimit të ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës

që po zhvillohet në Bruksel, ku mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Niko Peleshi.

Ministrat diskutuan mbi forcimin dhe modernizimin e Strukturës së Forcave të NATO-s, me qëllim përgatitjen e vendimeve që udhëheqësit e NATO-s do të marrin

në Samitin e Madridit më 29-30 qershor 2022.

Ministri Peleshi nënvizoi rëndësinë e kontrollit politik mbi gjithë Procesin e Implementimit të Parandalimit ndaj rreziqeve dhe Mbrojtjes së zonës euroatlantike dhe në veçanti, rritjen e ndërgjegjësimit të



Forcat tona të Armatosura, dislokuan një kompani të Policisë Ushtarake, të cilët do të japin kontributin e tyre për ruajtjen dhe sigurinë e kampionit "Bechtel" në afërsi të Ferizajt

përsëri një strehë e sigurt për grupet terroriste.

Në fjalën e tij, z. Peleshi vlerësoi kontributin e vendit tonë në këtë mision të NATO-s në Afganistan duke theksuar se edhe pse vendi i vogël, Shqipëria ka dhënë kontribute të mëdha atje, çka është vlerësuar në vazhdimësi nga udhëheqja politiko-ushtarake e Aleancës.

Ministri Peleshi përmendi edhe kontributin aktual që Shqipëria po jep për të ndihmuar refugjatët afganë. "Aktualisht vendi ynë ka pranuar rreth 2000 qytetarë afganë dhe zotimi i qeverisë shqiptare është të mirëpresë rreth 4000 të tillë. Për më tepër, vetëm pak javë më parë, Forcat tona të Armatosura, dislokuan një kompani të Policisë Ushtarake, të cilët do të japin kontributin e tyre për ruajtjen dhe sigurinë e kampionit "Bechtel" në afërsi të Ferizajt, ku janë akomoduar refugjatët afganë të strehuar në Kosovë." - u shpreh ai.

Në përfundim të këtij takimi, ministrat firmosën "Letrën e Qëlimit", nëpërmjet së cilës vendet anëtare zotohen të bashkëpunojnë mbi zhvillimin e menaxhimit dhe zbulimit të agjentëve kimikë, biologjikë dhe radiologjikë, si dhe identifikimin e kapaciteteve, por njëkohësisht edhe për sigurimin e pajisjeve mbrojtëse kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore.



Aleancës për sa i përket Drejtimit Strategjik të Jugut, me fokus në Ballkanin Perëndimor.

Më tej, zoti Peleshi ripërsëriti vendosmërinë e vendit tonë për zbatimin e zotimeve të marra në Samitin e Uellsit në vitin 2014, që konsistojnë në arritjen e nivelit 2%

të buxhetit të mbrojtjes dhe 20% të këtij buxheti në investime, deri në vitin 2024.

Sa i përket Afganistanit, ministrat diskutuan se si mund të shfrytëzohen arritjet e Aleancës në këtë vend, si dhe hapat që duhet të ndiqen që vendi të mos bëhet

Vëmendje më të madhe ndaj Kosovës, e cila është në të drejtën e saj

Peleshi, homologëve të NATO-s: Kosova nuk është as çerek shteti, as gjysmë shteti, por shtet në kuptimin e plotë të fjalës

Në ditën e dytë të takimit të ministrave të vendeve të Aleancës në Bruksel, udhëheqësit politikë diskutuan edhe për bashkëpunimin NATO - BE. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Shqipëria ka kontribuar për tre vite në misionin e NATO-s në detin Egje, por për t'u nënvizuar janë edhe prezenca e Forcave të Armatosura shqiptare në Mali dhe në Bosnje dhe Hercegovinë.

Në këtë sesion, ministri Peleshi u ndal edhe në rolin në rritje të Rusisë dhe Kinës në këtë rajon. "Këto dy vende po avancojnë objektivat e tyre strategjikë në rajonin tonë, nëpërmjet lidhjeve të tilla historike, kulturore, ekonomike, apo nëpërmjet influencës së tyre në vende apo pjesë të rajonit", -u shpreh ai.

Ministri Peleshi përpara homologëve të tij nuk la pa përmendur edhe ngjarjet e javëve të fundit në Kosovë, për të cilat ai kërkoi vëmendje më të madhe nga Aleanca. "Ngjarjet e fundit të ndodhura në veri të Kosovës nuk janë dhe nuk duhet të trajtohen si të izoluar. Ne jemi dëshmitarë të një modeli shqetësues që na prezantohet nga pala serbe, e cila vijon të pajset me sisteme moderne armatimi nga Rusia dhe Kina, stërviten bashkërisht dhe, siç ishim dëshmitarë së fundmi, dërgoi trupa ushtarake në kufirin me Kosovën, të cilët u "bekuan" edhe nga ambasadori rus në Beograd. Në këndvështrimin tonë ky është një mesazh shumë shqetësues, të cilit Aleanca duhet

t'i kushtojë rëndësinë e duhur.

Shqipëria, të gjithë ne në NATO, apo në BE, duhet të jemi të kujdesshëm që në rastin më të mirë

t'i "kalibrojmë" qasjet dhe deklaratat që të mos mbeten të paqarta kur ushtria serbe i afrohet kufirit të Kosovës, e cila është në të drejtën e



saj dhe i duhen njohur përpjekjet për të siguruar rend dhe siguri për të gjithë qytetarët. Kosova nuk është as çerek shteti, as gjysmë shteti, por shtet në kuptimin e plotë të fjalës.” - theksoi ministri Peleshi. Gjatë punimeve të këtij Ministeriali, z. Peleshi u takua edhe me ministrat e Mbrojtjes së vendeve kontribuuese në misionin e NATO-s në Letoni. Ministrat diskutuan kontributet aktuale dhe ato të planifikuara, si dhe çdo çështje që ka të bëjë me mbarëvajtjen e këtij angazhimi. Shqipëria është një ndër vendet që kontribuon në Grup-Batalionin e NATO-s në Letoni, i cili ka në përbërje ushtarakë nga vende të tilla si: Kanadaja, Çekia, Italia, Mal i Zi, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja. Deri më tani vendi ynë ka kontribuar në këtë mision me 1392 trupa në total.



Ministri Peleshi përpara homologëve të tij nuk la pa përmendur edhe ngjarjet e javëve të fundit në Kosovë, për të cilat ai kërkoi vëmendje më të madhe nga Aleanca. Ngjarjet e fundit të ndodhura në veri të Kosovës nuk janë dhe nuk duhet të trajtohen si të izoluar.



Peleshi: "Defender 2021", histori sukcesi

Shqipëria, gati të shërbejë sërish si vend pritës i stërvitjes më të madhe "Defender 23"

Shqipëria ka nisur punën për të pritur sërish një nga stërvitjet më të mëdha "Defender 2023". Për këtë u organizua edhe konferenca koordinuese, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, ambasadorja e SHBA-së në Tiranë Yuri Kim si dhe përfaqësues të lartë ushtarakë të SHBA-së dhe Shqipërisë.

Në fjalën e tij, me këtë rast ministri Peleshi e cilësoi një histori sukcesi stërvitjen "Defender 2021", e cila u zhvillua disa muaj më parë.

"Kjo stërvitje shkon përtej gjithë dimensionit ushtarak", ministri konfirmoi përfshirjen dhe gatishmërinë e të gjithë qeverisë për të ndihmuar dhe lehtësuar të gjitha kërkesat specifike dhe të përgjithshme për ekzekutimin e saj të shpejtë. Stërvitje të tilla me shikueshmëri të lartë tregojnë rëndësinë strategjike të Politikës së Zgjeruar të Parandalimit të SHBA-së për NATO-n, aleatët dhe partnerët e saj evropianë si dhe rithekson angazhimin e fortë që Aleanca, dhe në veçanti Shtetet e Bashkuara, i kushtojnë rajonit tonë. "Defender Europe". "Për ne, mbetet një mjet i fuqishëm i komunikimit strategjik i paqes, sigurisë, stabilitetit dhe garancisë për qytetarët tanë, vendet e rajonit dhe mbarë Evropën", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Teksa siguroi mbështetjen dhe ndihmën maksimale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FA-së për stër-

vitjen e radhës "Defender 23", ministri Peleshi tha se Shqipëria konfirmoi gatishmërinë të shërbejë sërish si vend pritës për serinë e

Defender. Ndërsa në fjalën e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj u shpreh i sigurt se "Defender Eu-



rope -23' përmes aktiviteteve dhe demonstrimit të aftësive të saj do t'u japë kundërshtarëve një mesazh të qartë dhe të fortë parandalimi dhe mbrojtjeje". "Është një privilegj për ne që të presim konferencën e parë të planifikimit për stërvitjen "Defender Europe 23" dhe sigurisht një mesazh i qartë për rëndësinë dhe rolin e Shqipërisë dhe Evropës Juglindore jo vetëm për Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe për Aleancën. Jam i sigurt se përmes aktiviteteve dhe demonstrimit të aftësive të saj do t'ju japë kundërshtarëve një mesazh të qartë dhe të fortë parandalimi dhe sigurie. Shqipëria është e prirur dhe ambicioze të presë një pjesë të stërvitjes "defender Europe 23" në territorin tonë", u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.



Ushtarakë e zyrtarë nga Kosova dhe vende të NATO-s pjesë e tij

Shqipëria organizon Kursin e Lartë për Studimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) po organizon Kursin e Lartë për Studimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes (SCSDS) 2021, ku marrin pjesë dhe shumë vende të tjera.

Qëllimi i SCSDS është të edukojë oficerë ushtarakë (OF5) dhe zyrtarë civilë nga Shqipëria, NATO dhe vendet partnere në nivelin strategjik.

Kursi u përpilua nga studentë nga Shqipëria, Gjermania, Greqia, Bullgaria, Kosova, Italia dhe Gjeorgjia.

Në këtë aderim, AFA ftoi si lektor dhe anëtarë të fakultetit të Kolegjit të Mbrojtjes Baltike për mësimdhënie, Dr. Sandis Šraders dhe COL (R) Dr. Clirim Toci dhanë leksione në SCSDS për disa çështje që sfidojnë mjedisin e sigurisë si: Rusia,



roli i NATO-s, interesat kombëtare dhe dinamika e fuqisë kombëtare, zhvillimi i luftës në Evropë dhe NATO dhe sfidat ushtarake që mund të paraqiten nga NATO.

Ky projekt ishte hapi i parë në rritjen e bashkëpunimit të mirë, të rënë dakord gjatë vizitës së ministrit shqiptar të Mbrojtjes Niko Peleshi, në qershor 2021 në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes.

Akademia e Forcave të Armatosura

Gjeneral brigade Albert Mullai: Dimension i ri dhe vlerë e shtuar në “jetën e re” të studentëve nën uniformën ushtarake

“Ky vit është një vit i veçantë në disa pikëpamje, më lejoni t’ju them se është një vit i vështirë jo vetëm se, Ju po kaloni nga jeta civile në një jetë të re, atë nën uniformë por në disa dimensione”.

Hapet viti Akademik 2021-2022 për programet e studimeve të ciklit Bachelor dhe të Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri në AFA. Në datën 18 tetor, në Akademinë e Forcave të Armatosura filloi viti i ri Akademik 2021-2022 për studentët e ciklit Bachelor dhe të Kursit të Përgatitjes të Oficerit të Ri.

Me këtë rast u bë ceremonia e çeljes, ku u zhvillua në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarit (QAPU) Bunavi, Vlorë.

Studentët u përshëndetën nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Albert Mullai. Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti u shpreh:

“Ky vit është një vit i veçantë në disa pikëpamje, më lejoni t’ju them se është një vit i vështirë jo vetëm se, Ju po kaloni nga jeta civile në një jetë të re, atë nën uniformë por në disa dimensione. Normalisht jeta juaj tashmë ka ndryshuar, ka marrë një dimension të ri. Ju po i shtoni vetes vlera të tjera si në kuptimin intelektual, atë moral, në atë të përgatitjes fizike e në tërësinë e formimit tuaj, për t’u përgatitur për jetën si oficerët e ardhshëm por

edhe për jetën tuaj familjare. Natyrisht kjo që ju po bëni është një kalim cilësor në të mirë të tërë të ardhmes tuaj, por edhe për zhvillimin e gjithë vendit tonë. Ju jeni e ardhmja e ushtrisë tonë e cila kërkon përgatitje intelektuale, përgatitje fizike, përgatitje gjuhësore, përgatitje psikologjike si dhe natyrisht edhe intelektuale. Ju do të shërbeni në të gjitha strukturat e Forcave tona të Armatosura, brenda dhe jashtë vendit, e kjo është një përgjegjësi e madhe, përgjegjësi për të cilën ju jeni të ndërgjegjshëm e për të cilën instruktorët e mësuesit tuaj janë të angazhuar bashkë me ju për ta arritur me sukses. Aktualisht në Akademinë e Forcave të Armatosura do të vijojnë studimet në programin Bachelor 58 studentë në vitin e parë, ndër të cilët 14 janë femra, ndërkohë në kursin e Përgatitjes e Oficerit të Ri (KPO) do të studiojnë 58 studentë, djem e vajza nga e gjithë Shqipëria. Për herë të parë sivjet janë çelur edhe dy degë të reja për Navigim dhe Komandim Detar si dhe për IT në Fushën e Mbrojtjes, që së bashku me degën e Shkencave Ushtarake përbëjnë tërë spektrin e përgatitjes së kadrove të ardhshëm të FA-së.





Gjenerallejtënant Fernando De La Cruz Caravaca, vizitë zyrtare në Shqipëri

Gjeneral Caravaca: Do të vijojmë kryerjen me përkushtim të misionit, për të qenë në lartësinë e sfidave me të cilat përballlet NATO

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti në një takim komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO, gjenerallejtënant Fernando De La Cruz Caravaca, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Shqipëri. Ministri Peleshi falënderoi gjeneral Caravaca për punën që ai dhe stafi i tij bëjnë për vëzhgimin dhe policimin e hapësirës ajrore të NATO-s dhe në veçanti, falënderoi fqinjët tanë, Italinë dhe Greqinë për kontributin e dhënë për policimin e hapësirës ajrore të vendit tonë. Ministri i Mbrojtjes e njohu gjeneral Caravaca mbi ecurinë e projektit të Bazës Ajrore Kuçovë, si dhe projektet e tjera të modernizimit, sidomos ato



që kanë të bëjnë me Forcën Ajrore, me fokus të veçantë në funksionimin e Radarit të Midës. Nga ana e tij, gjeneral Caravaca e siguroi ministrin Peleshi se personeli i Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO-s do të vijojë kryerjen me përkushtim të misionit, për të qenë



në lartësinë e sfidave me të cilat përballlet NATO. Gjithashtu, gjeneral Caravaca shprehu gatishmërinë të mirëpresë angazhimin e vendit tonë, që nëpërmjet Radarit të Midës, të kontribuojë në krijimin sa më të plotë të pamjes së përbashkët të hapësirës ajrore të Aleancës.



Efektivët e Forcës Ajrore trajnim për sistemin e komunikimit tokë - ajër - tokë

Peleshi: Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë

Efektivët e Forcës Ajrore trajnim për sistemin e komunikimit tokë - ajër - tokë, Peleshi: Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë, ta update sa herë të jetë e nevojshme, ta bëjmë upgrade kur të vijë koha me burimet tona.

Sistemi i radio komunikimit tokë - ajër - tokë ka mbledhur në një trajnim 4 - javor personelin ndërlidhës të Komandës së Forcës Ajrore. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, teksa përshëndeti efektivët në Bazën Ajrore të Farkës, kërkoi prej tyre të mësojnë sa më shumë nga ky trajnim, pasi është shumë i rëndësishëm për të ardhmen, për ta mbajtur gjatë gjithë kohës në funksion sistemin. "Unë vetëm një kërkesë kam që, pasi të konfigurohet ky sistemi i komunikimit tokë - ajër - tokë, të jetë 100% efektiv, siç e kemi planin, në dhjetor. Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë, ta update sa herë të jetë e nevojshme, ta bëjmë upgrade kur të vijë koha me burimet tona, jo të presim gjithmonë kontraktin".

Në fjalën e tij ministri Peleshi tha, se një sistem i tillë është i nevojshëm, veçanërisht në kohë emergjencash civile, në përmbajtje, gjatë periudhës së verës, kur ka vatra zjarri, ndaj vuri theksin te ndërtimi i kapaciteteve të brendshme.

Ky sistem komunikimi tokë - ajër - tokë synon mbulimin mbarëkombëtar në lartësinë 150 m mbi lartësinë e tokës, të 95% të territorit.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe komandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj).

Në Qendrën Stërvitore Pashaliman ka përfunduar kursi SAR dhe Bording

Në Qendrën Stërvitore Pashaliman ka përfunduar kursi SAR dhe Bording, i cili u zhvillua në një periudhë dy javore dhe morën pjesë pesë kursantë. Pjesa e trajnimit u realizua në dy faza teorike mbi njohurit e SAR dhe Bording gërshetuar këto në veprime praktike, të cilat u zhvilluan dhe në det sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare. Kursantët gjatë kësaj periudhe kanë treguar disiplinë të lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare, Pashaliman krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi të rëndësishëm.



Gjeneralmajor prof.asoc. Bajram Begaj: Kapacitetet e Forcës Detare janë një aset i rëndësishëm i FA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zhvilloi një vizitë inspektuese të stërvitjes "Flotex-21", faza e ekzekutimit të së cilës po zhvillohet në Gjirin e Vlorës në periudhën 18-22 tetor 2021. Stërvitja Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe çertifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Në prezantimin e stërvitjes, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Sabri Gjinollari, njohu shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA me qëllimin, objektivat dhe skenarin e stërvitjes. Qëllimi i stërvitjes është rritja e ndërveprueshmërisë midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare,



si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR). Gjeneralmajor Begaj vlerësoi përkushtimin e treguar nga efektivat pjesëmarrëse në stërvitje duke theksuar fak-

tin se kapacitetet e Forcës Detare janë një aset i rëndësishëm i Forcave të Armatosura dhe kontributi i tyre në realizimin e misionit kushtetues të Forcës Detare dhe atë ligjor të Rojes Bregdetare, është jetik në sigurinë e vendit.

Bashkëpunimi midis dy vendeve dhe angazhimet e mëtejshme që do kenë në të ardhmen

"USNS Trenton" Anija e Forcave Detare Amerikane e cila përdoret nga Marina Amerikane për transport pajisjesh, ka zhvilluar një vizitë portuale në portin e Durrësit, nga data 15-19 tetor 2021.

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, vizitoi anijen amerikane "USNS Trenton" dhe u prit nga kapiteni i anijes Douglas Casavant si edhe kapiten i rangut të dytë Tommy Seifert, komandanti i anijes amerikane "USNS Trenton".

Gjatë takimit kapiteni Douglas Casavant u shpreh se "është kënaqësi të mirëpresim komandantin e Forcës Detare shqiptare duke vlerësuar bashkëpunimin midis dy vendeve dhe angazhimet e mëtejshme që do kenë në të ardhmen".

Gjithashtu komandanti i anijes Amerikane "USNS Trenton" kapiteni i rangut të dytë Tommy Seifert, zhvilloi një takim me komandantin e Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia në komandën e Forcës

"USNS Trenton", Anija e Forcës Detare amerikane, vizitë në Portin e Durrësit



Detare.

Gjithashtu edhe gjeneral brigade Ilir Xhebexhia i shprehu mirënjohje dhe falenderime për bashkëpunimet e suksesshme të dyanshme që do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Ekupazhi i anijes "USNS Trenton", të shoqëruar nga koordinatore të Forcës Detare, zhvilluan vizita në qytetet historike të Krujës dhe Durrësit duke i njohur me objektet muzeale, historike dhe turistike.



ÇERTIFIKOHEN EFEKTIVËT NDËRLIDHËS TË FORCËS AJRORE

Përfundon trajnimi 4-javor për sistemin e radio-komunikimit Tokë-Ajër-Tokë

Në Forcën Ajrore u zhvillua ceremonia e çertifikimit të efektivëve ndërlidhës për sistemin e radio-komunikimit Tokë-Ajër-Tokë. Të pranishëm në aktivitet ishin zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, ekspertët trajnues, shefat dhe personeli të strukturave të ndërlidhjes në Forcën Ajrore.

Kolonel Ylli Pulaj përshëndeti pjesëmarrësit për realizimin me sukses të këtij trajnimi tepër të rëndësishëm për Forcën Ajrore dhe Forcat e Armatosura si dhe vlerësoi rëndësinë e madhe që karoli dhe performanca e personelit, të cilët do të punojnë për implementimin e projektit Tokë-Ajër-Tokë (GAG), i cili rrit së tepërmi aftësinë e radio-komunikimit Tokë-Ajër-Tokë brenda Forcave të Armatosura dhe ndërveprueshmërinë me operacionet me vendet anëtare të NATO-s, dhe veçanërisht në kuadër të operacioneve të përbashkëta të emergjencave civile brenda territorit të RSH.

Shefi i ndërlidhjes i Forcës Ajrore, kolonel Gjergji Vasili, cilësoi të suksesshëm procesin e trajnimit duke evidentuar punën e mirë të bërë nga të trajnuarit, ushtarakët ndërlidhës të Forcës Ajrore Shqiptare dhe trajnuesit e huaj, ekspertë inxhinierë anglezë. Ai theksoi se, ky trajnim 4-javor

si pjesë e projektit do shërbejë për konfigurimin, operimin dhe përdorimin e sistemit, si dhe trajnimi do vijojë përsëri me procesin e kombinuar "trajnim-instalim" për 6 javë të stafit teknik për instalimin e sistemit, pajis-

jeve të sistemit të radio-komunikimit Tokë-Ajër-Tokë në terren sipas projektit, deri në vendosjen në operacionet pune të këtij sistemi. Në fund të aktivitetit u shpërndanë çertifikatat për secilin ushtarak ndërlidhës.

Atasheu ushtarak francez kolonel Nicolas Coussiere viziton Forcën Ajrore

Kolonel Pulaj: Prioritet transformimi i Bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s

Atasheu ushtarak francez, rezident në vendin tonë, kolonel Nicolas Coussiere u prit në një takim nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj në Komandën e Forcës Ajrore. Në këtë takim, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore i uroi mirëseardhjen atasheut ushtarak francez si dhe e njohu atë me zhvillimet e deritanishme të Forcës Ajrore duke theksuar edhe bashkëpunimin ushtarak me ushtrinë franceze në interes të projekteve të modernizimit në vite, si dhe trajnimin e pilotëve për helikopterin Cougar por edhe të teknikëve të Forcës Ajrore. Atasheu ushtarak francez falënderoi për pritjen dhe shprehu gatishmërinë e vijimit të këtij bashkëpunimi në të ardhmen duke identifikuar nevojat dhe planifikuar fushat e bashkëpunimit. Kolonel Pulaj, njohu gjithashtu kolonel Coussiere me ecurinë e projekteve të modernizimit të Forcës Ajrore duke përfshirë projektin e transformimit të Bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s. Takimi u mbyll në një frymë mirëkuptimi për vijimin e bashkëpunimit në fusha specifike me interes të përbashkët.

Atasheu ushtarak gjerman, nënkolonel Dirk Weber viziton Forcat Ajrore

Kolonel Pulaj: Bashkëpunimi ushtarak me ushtrinë gjermane një rëndësi e veçantë për trajnimin e burimeve njerëzore dhe teknikës ajrore

Atasheu ushtarak gjerman, nënkolonel Dirk Weber është pritur në takim nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj dhe shefi i Shtabit të Forcës Ajrore kolonel Arben Cenolli, në Garnizonin Rinas.

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore shprehu kënaqësinë për këtë vizitë si dhe vlerësoi bashkëpunimin ushtarak me ushtrinë gjermane në vite, duke iu referuar mjeteve dhe teknikës ajrore kryesisht për helikopterët BO 105, si dhe trajnimeve të burimeve njerëzore si pilotë, teknikë mirëmbajtjeje etj.

Atasheu ushtarak gjerman falënderoi për pritjen si dhe theksoi se, bashkëpunimet midis ushtrisë gjermane dhe shqiptare janë të mirëpritura duke eksploruar fushat e



mbështetjes e bashkëpunimit edhe në kuadër të NATO-s.

Në fund, kolonel Pulaj dhe nënkolonel Weber vlerësuan takimin, në të

cilin shkëmbyen informacione të vlefshme për vijimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak në fushat me interes të përbashkët.

Batalioni i Mbështetjes Rajonale

Mikpritja e Forcave të Armatosura ndaj refugjatëve afganë vazhdon të jetë prioriteti më i rëndësishëm i aktivitetit të tyre. Këtë javë në aeroportin e Rinasit mbërritën të tjerë refugjatë afganë në Shqipëri. Ata u pritën në qendrën e pritjes, e cila shërben edhe si pikë transiti për ta. Komanda e Mbështetjes me efektivin e Batalionit të Mbështetjes Rajonale (BMR) ka qenë e angazhuar që në momentet e para të operacionit të koduar "Mikpritja" të pritjes së refugjatëve nga Afganistani në qendrën e ngritur në Garnizonin e Rinasit. Më konkretisht Komanda Mbështetëse ka dhënë një kontribut të veçantë në krijimin e kushteve për qëndrimin dhe pritjen e refugjatëve afganë. Efektivët e Batalionit të Mbështetjes Rajonale kanë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe kanë punuar për kampingun nëpërmjet ngritjes së çadrave të pajisura me gjenerator, kondicioner, kulla ndriçimi, tavolina, karrige e pajisje të tjera

Ushtarakët e KM, kontakti dhe mbështetja e parë e afganëve në Shqipëri



të nevojshme. Ndërkohë Batalioni i Furnizimit Komandës Mbështetëse ka siguruar nyjat sanitare (tualette, dushe) dhe kujdeset për funksionimin e mirëmbajtjen e tyre. Efektivët e BMR-së vijojnë kontributin e tyre në pritjen e refugjatëve afganë, të

cilët kanë hyrë për herë të parë në Shqipëri, më datë 27.08.2021, me krijimin e kampingut duke u bërë kështu kontakti dhe mbështetja e parë e afganëve në Shqipëri. Ky operacion zhvillohet në bashkëpunim me Policinë Ushtarake.

Njësi mamografie edhe për vajzat dhe gratë e FA

Tetori rozë, zëvendësministrja e Mbrojtjes: Mos hezitoni, pa gruan nuk ka jetë!

Drejtoje Timonin nga Shëndeti Yt! Tetori Rozë si muaji i ndërgjegjësimit global për të rritur ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit. Vetëkontrolli mujor dhe ekzaminimi nga personeli shëndetësor janë mënyrat e kontrollit më efektive që ndihmojnë në diagnostikimin në kohë të kancerit të gjirit!

Edukimi dhe informimi për shenjat dhe simptomat që lidhen me kancerin e gjirit janë kryesore gjatë këtij muaji.

Tetori, në të gjithë botën është muaji i ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Një sëmundje e cila sipas të dhënave nga OBSH shkakton rreth 680.000 vdekje gjatë një viti në rang global. Ky lloj kanceri është një nga llojet më të shpeshta të tumoreve tek gratë, kryesisht tek ato të moshës mbi 35 vjeç.

Për nga prekshmëria dhe vdekshmëria, renditet në vendin e parë në sëmundshmërinë e popullsisë femërore në tërë botën e industrializuar. Kontinenti amerikanoverior (SHBA dhe Kanadaja) rezulton të ketë prekshmërinë më të lartë, zbulohen çdo vit 90 raste në 100.000 gra. Në Europë dhe në Australi të dhënat tregojnë për një përhapje paksa më të ulët. Në vendet e BE, çdo vit preken 300.000 gra nga kjo sëmundje. Afrika Qendrore, Amerika Latine dhe Europa



Lindore kanë parametra shumë më të ulët, pothuajse të përgjysmuar në krahasim me Perëndimin, ndërsa në Japonim kanceri i gjirit është fare pak i përhapur. Në përgjithësi në Azi e në Afrikë është shumë më pak i përhapur se sa në Perëndim.

Sipas kërkuesve shkencorë në këtë fushë, këto diferenca kanë të bëjnë jo vetëm me pozicionin gjeografik dhe shkallën e zhvillimit industrial, por parasëgjithash me stilin e të jetuarit, mjedisin dhe ushqimin.

Studimet tregojnë se familjariteti me këtë lloj kanceri rrit rrezikun, por kjo nuk do të thotë se sëmundja është gjenetike dhe trashëgueshme në të gjitha rastet. Konsiderohet i trashëgueshëm vetëm kur kanceri



i gjirit shpreh dy onkogjene, BRA 1 dhe BRA 2 të cilët gjenden respektivisht në kromozomën 3 dhe në kromozomën 17, por këto rastë përbëjnë një përqindje të vogël (5-10 %) të të gjitha neoplazive të gjirit.

Në Shqipëri kanceri i gjirit është mjaft i përhapur, rreth 650 raste të rinj çdo vit, shifër e lartë për popullsinë femërore të moshës mbi 30 vjeç të vendit.

Për të sensibilizuar gratë dhe vajzat në uniformë, pranë Garnizonit "Skënderbej", është vendosur një njësi e lëvizshme mamografie për kontrollin e tyre.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici shoqëruar edhe nga zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu ishin të pranishme në këtë pikë, ku çdo ditë vijon kryerja e ekzaminimeve.

Zëvendësministrja Bici iu drejtua me një mesazh të gjitha vajzave dhe grave të FA: "Mesazhi im sot nuk vjen si zëvendësministre, por mbi të gjitha si grua dhe këtë mesazh sensibilizues e kam përtej grave në uniformë! Ky mesazh është për çdo grua, nënë, motër apo bashkëshorte! E vetmja mënyrë që kemi për të shpëtuar veten është zbulimi i hershëm! Mos hezitoni në asnjë moment të bëni kontrollet! Pa gruan nuk ka jetë!", - u shpreh zëvendësministrja Dallëndyshe Bici. Znj. Bici tha

se kjo sëmundje e tmerrshme nuk ka kursyer as gratë në uniformë, ndaj Ministria e Mbrojtjes, së bashku me Shtabin e Përgjith-

shëm të Forcave të Armatosura ka ndërmarrë këtë aktivitet, i cili do të vazhdojë përgjatë gjithë tetorit dhe jo vetëm.



Gratë në Politikat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë II

Vajzat dhe gratë në politikat e sigurisë, zv/ministrja e Mbrojtjes: Kemi rritur përfaqësimin e tyre në FA

Përfshirja e gruas në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes sjell vetëm pozitivitet

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes dijes dhe zhvillimit të gjeneratës së ardhshme si kontribuese proaktive në politikat e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare ishte në qendër të aktivitetit të organizuar me rastin e fillimit të veprimtarisë së Institutin për Gratë në Politikat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë II, projekt i financuar nga Ambasada e SHBA. Pjesë e aktivitetit ishte edhe zëvendësministrja e Mbrojtjes Dalëndyshe Bici, ambasadorja e SHBA Yuri Kim, kryetari i Prezencës së ON. Në fjalën e saj përshëndetëse, zëvendësministrja e Mbrojtjes theksoi se, arsimimi, kualifikimi dhe shanset e barabarta të shtrira në mënyrë kapilare në shoqëri janë mënyra më e mirë për t'i dhënë fund dramës së tranzicionit të gjatë që po lodh deri në sfilite pjesën më të brishtë dhe njëkohësisht më të fortë të shoqërisë tonë, gruan.

Duke u përqendruar tek roli dhe përfaqësimi i gruas në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, zëvendësministrja Bici u shpreh se krahasuar me vite më parë ka rritje të nivelit të për-

faqësimit të vajzave dhe grave, referuar statistikave të vitit 2019 dhe 2020.

Po ashtu, shtoi znj. Bici, ka rritje me 2,5% edhe sa i përket numrit të rekrutimeve të vajzave dhe grave në FA, duke vënë në dukje pjesëmarrjen e tyre në misione ndërkombëtare, në misione të emergjencave civile në ndihmë të popullsisë, në stërvitje, konkurse dhe gara, përherë me një përfaqësim dinjitoz dhe shumë profesional.

Ajo përmendi faktin që zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është një grua, e cila gëzon gradën e lartë të gjeneralmajorit.

Znj. Bici kujtoi edhe "Dëshmoren e Atdheut", tetare Zariqe Hasanaj, e cila humbi jetën e saj të re në krye të detyrës, gjatë misionit ushtarak të NATO, në Letoni. Pavarësisht arritjeve, zëvendësministrja e Mbrojtjes u shpreh se, "ka ende shumë për t'u bërë në këtë drejtim. Përfshirja e gruas në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes sjell vetëm pozitivitet. Kjo falë mendjes së kthjellët, intuitës së jashtëzakonshme dhe gjykimit racional, karakteristika natyrale këto tek një grua".





KLSM, vizitë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë

Mehja: Transformimi i FSK-së është tashmë një proces që ka si synim final anëtarësimin në NATO të Kosovës

Në kuadër të programit akademik të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes që po zhvillohet në AFA, nga data 5 tetor deri më datën 7 tetor, ky kurs kreu një vizitë mësimore në Republikën e Kosovës.

Objekt i kësaj vizite ishte njohja e pjesëmarrësve të kursit në Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Kosovë. Për këtë qëllim sipas programit u vizituan disa institucione të rëndësishme;

- Ditën e parë, kursi u prit nga Nënkrjetari i Komisionit të Sigurisë së Kuvendit të Kosovës, Z. Enver Dugolli (kolonel në R) dhe disa përfaqësues të këtij komisioni.

Në këtë takim u fol kryesisht për situatën në Kosovë e rajon, si dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë mes dy shteteve shqiptare.

Zv. Dekania e FMS në AFA, Dr. Etleva Smaçi informoi Komisionin e Sigurisë së Kosovës për bashkëpunimin në fushën akademike mes dy vendeve.

- Ditën e dytë, KLSM pati një pritje të veçantë nga Ministri i Mbrojtjes së Kosovës Z.

Armend Mehja, i cili përmes një vështrimi të përgjithshëm përcolli gjatë tek kursantët mesazhet se transformimi i FSK - së është tashmë një proces që ka si synim final anëtarësimin në NATO të Kosovës. Ministri i Mbrojtjes pati një bashkëbisedim të frytshëm me kursantët në lidhje me çështjet e sigurisë rajonale dhe me gjerë. Takimet e rradhës në ditën e dytë ishin me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FSK - së gjeneral brigade Jeton Dreshaj dhe Komandantin e KDS gjeneral brigade Irfete Spahiu. Të dyja këto takime në FSK u shoqëruan me diskutime mes kursantëve dhe mikpritësëve mbi vizionin e FSK - së dhe ak-

tivitetet në fushën e arsimit ushtarak.

KLSM u vizitua gjithashtu nga ambasadori shqiptar në Kosovë, Z. Qemal Minxhozi.

- Vizita mësimore u përmbyll me takim në KFOR, ditën e tretë. KLSM u prit nga gjeneral brigade John P. Mailer.

Fokusi i këtij takimi ishte njohja me organizimin e KFOR-it dhe objektivat e KFOR në raport me konsolidimin e institucionet e sigurisë në Kosovë.

Krahas aktiviteteve akademike vizita shërbeu edhe për njohjen më të gjerë nga ana e kursantëve e historisë dhe traditave të popullit kosovar.



Përgatitja moralo- psikologjike

Edukimi moralo-psikologjik

Mbështetur në përvojën e luftërave, mendimi ushtarak e ka vlerësuar faktorin moral si parësor, sepse kur lidhet drejt me faktorët e tjerë materialë, teknikë e ushtarakë, ai përmbys vlerësime e raporte të ndryshme forcash. Në të kundërt, kur morali vlerësohet nga pozita burokratike në mënyrë të njëanshme, si qëllim në vetvete, i idealizuar e i politizuar, në situata luftarake si vështirësia, po ashtu dhe pengesa më e vogël e komprometon përmbajtjen e tij, krijon zbrazëti shpirtërore e krizë që të çojnë drejt katastrofës. Parë në këtë prizëm, përgatitja moralo-psikologjike është e pandashme nga ajo ushtarakë, nga aspekti komandues e drejtues. Edukimi moralo-psikologjik, që bëhej në mënyrë dogmatike në ushtri, në kohën e monizmit sollti në shumë raste një shkëputje të tij nga faktorët ushtarakë. Absolutizimi i moralit dhe glorifikimi i tij sollën moralizime të pafund, skema, formalizëm dhe eufori. Të ashtuquajturat "gjendje e lartë moralopolitike", "uniteti i çeliktë", "bindje e besim absolut në drejtësinë e çështjes" etj., jo vetëm ishin pjellë e dukurive të mësipërme, por edhe u kthyen në një kod moral të mërzitshëm e pa jetë, që shoqëronte të gjithë jetën në ushtri. Ndikimi i faktorëve materialë e ushtarak, sidomos në luftë, ndaj faktorëve moralë

Luftrat I fitojnë njerëzit dhe jo armët

Mesazhi i historisë së luftërave nga ato primitive e deri tek ato moderne është se, ato gjithmonë i kanë fituar njerëzit



Psikologjia njerëzore në kushtet e aktivitetit ushtarak

‘Jo vetëm muskuj, stërvitje e ashpër dhe kurajo. Luftrat tani fitohen edhe me forcën e psikologjisë dhe një mendje të mësuar të mendojë pozitivisht’

dhe jo armët. Kushdo që e ka haruar këtë, shpejt ose vonë, është detyruar ta kujtojë. "Një divizion me gjendje të lartë morale, thek-

son Klauzeviçi, mund të zëvendësojë së paku tre divizione që nuk e kanë këtë cilësi. Morali i lartë është forcë lëvizëse me rëndësi përcaktuese, armë gjithmonë e re e në veprim, mjeti për të fituar luftën apo për të shndërruar disfatën në fitore”¹. Cilado ushtri qoftë nuk mund të quhet e shkatërruar, përderisa nuk përshkohet nga ndjenja e disfatës, sepse disfata është përfundim i arsyes dhe jo një gjendje fizike. Në të vërtetë popujt, ushtritë, kombet për sa kohë që tek ata ka ekzistuar vullneti, vendosmëria, idealet e aspiratat për të mos iu nënshtruar asnjë lloj pushtimi, dhune fizike e morale, nuk janë mposhtur, qoftë dhe në situata më të rënda, ata kanë ditur të luftojnë, janë organizuar, kanë gjetur forma e metoda lufte origjinale, duke iu kundërvënë me sukses armikut.

Psikologjia ushtarake (shkenca e sjelljes)

Këto çështje përfshijnë përzgjedhjen dhe klasifikimin e personelit ushtarak; procesit të mësuarit, teknologjisë ushtarake dhe armës në zotërim; karakteristikat individuale psikologjike të nevojshme për aktivitetet ushtarake; luftën psikologjike. Problemi themelor i psikologëve ushtarake dhe studiuesve të përfshirë në proces nuk është shumë e ndryshme nga përmbajtja e degëve të tjera të psikologjisë të përfshira, dallimi është vetëm se studimi është kryer në një mjedis ushtarak, zbatimin e ob-

jekteve ushtarake. Për këtë arsye, ajo gjithashtu përmban disa nga fushat tradicionale të hulumtimit psikologjik, kryesisht Psikologji Personelit (në lidhje me personelin në përzgjedhjes, klasifikimit, emërimet), psikologjisë së të mësuarit (trajnimet), psikologjisë eksperimentale, faktorët e njeriut hulumtim, psikologjisë sociale, psikologji klinike dhe psikologjia organizative. Sipas karakteristikave të armëve, psikologjia ushtarake mund të ndahet në hapësirën ajrore, detare dhe tokësore.

Psikologjia Ushtarake është zhvilluar e diferencuara nga psikologjia e profileve të tjera. JE Wu Lanna (1977) beson se diferencimi i saj filloi 6 prill 1917 në takimin Shoqata Psikologjike Amerikane. Në atë kohë, Shtetet e Bashkuara kanë qenë të përfshira në Luftën e Parë Botërore, në funksion të situatës, disa nga pjesëmarrësit e ngritën çështjen e psikologut eksperimental si mjaft të rëndësishëm në shërbimet e mbrojtjes. Takimi do të diskutonte historinë dhe studimin e psikologjisë ushtarake në fillim të supozuar. Aktualisht, shumë vende kanë institutin e këshillimit psikologjik ushtarak.

Kuptim

Fjala psikologji vjen nga greqishtja, që do të thotë shkencë e shpirtit. Soul në greqisht do të thotë gjithashtu të marrë frymë gaz apo për shkak se njerëzit e lashtë mendojnë se jeta është e varur në frymëmarrje, arrest respirator, jeta është e gjatë. Me zhvillimin e shkencës, objekti psikologjisë nga shpirti në shpirt. Deri në fillim të shekullit të 19-të, filozofi gjerman, edukatori Herbart propozoi psikologjinë si shkencë origjinale, psikologji, pedagogji të dyja i përkasin të njëjtës kategori të filozofisë, dhe më vonë të ndarë nga fillimet e tyre filozofike.

Psikologjia është studimi i fenomenit psikologjik të njerëzve dhe kafshëve, funksioni shkencor i mendjes dhe sjelljes, si një disiplinë teorike, por edhe në zbatimin e disiplinës.

Hulumtimet psikologjike përfshijnë, perceptimin, njohjen, shumë fusha të emocioneve, personalitetin, sjelljen dhe marrëdhëniet ndërpersonale, por edhe me shumë fusha të jetës së përditshme - familjen, arsimimin, shëndetësinë dhe shfaqje të tjera të ngjashme. Psikologjia në njërën anë përpiket të shpjegojë funksionimin e sjelljes dhe atij mendor, njëkohësisht përpiket të shpjegojë psikologjinë e rolit personal, funksionimin psikologjik në sjelljen sociale dhe dinamikat sociale të shoqërisë,



ndërsa ajo është e lidhur edhe me Neuroscience.

Provë

Në Luftën e Parë Botërore, në mënyrë që të përgjigjeshin një numër i madh ushtarësh për të plotësuar nevojat e luftës shpejt të klasifikuar, u zhvillua modeli i testit I grupi. Pas Luftës së Parë Botërore, kur një lloj testimi ushtarakësh si ai i (testimit të klasifikimit të nivelit arsimor) dhe testi B ushtarisë 'Class' (për ushtarët analfabet dhe jo-anglisht folës) kur përdoret në fusha jo-ushtarake, u realizua si model i testeve të zbulimit të grupit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për forcat ushtarake u realizua testi I klasifikimit të përgjithshëm

(AGCT). Ndërkohë, për shumë nga nevojat e veçanta të një përgatitje të veçantë testi ishte ai i pilotit bombardues, radio operator dhe teste të tjera të përzgjedhjes. Pastaj "Office kundërmasat" (OSS) ka përgatitur edhe seri veprimesh të përdorura në lloje të ndryshme të përzgjedhjes operator, test me letër të zakonshme, stilolaps proces testimi nga ana tjetër, është paraardhësi i vlerësimeve të mëdha moderne.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara dhe vende të

tjera për të studiuar teste ushtarake nuk e ndërprejnë 'operacionin e tyre'. Në Shtetet e Bashkuara, testi kualifikimi ushtarak (AFQT) zëvendësoi testin e mëparshëm atë të kualifikimit të përgjithshëm (AGCT). Puna në ushtri, përveçse studion tendencat psikologjike dhe testet e interesit, studion karakteristikat e një shumëllojshmëri të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për punën ushtarake. Në disa punë të veçantë ushtarak, trupi është aktiviteti primar, kështu që kur aplikanti rekrutohet renditen femra, e rëndësishme analiza e nevojave fizike.

Stërvitje

Marrëdhëniet, trajnimi dhe testimi janë të lidhura në mënyrë të



mirësimin të vazhdueshëm. Procesi themelor i studimit përfshin: përgjigjet fiziologjike të njerëzve për shkak të auditorit.

Klinik

Përveç psikologëve ushtarakë në modifikimin e sjelljes janë shkencëtarët dhe neurologë që punojnë ngushtë për të studiuar stresin dhe probleme të tjera të veçanta klinike.

Ka shumë studime të tjera që përfshijnë shndërrimin ideologjik, procesin e gjykimit dhe të privimit ndijor. Këto probleme origjinën e kanë në Luftën e Vietnamit, të Koresë, disa raste të veçanta, hulumtimi është i dominuar nga disa studiues të SHBA-së, Britania e Madhe dhe Kanada. Këto raporte paraqiten në "luftë psikologjike si një libër, përmbajtja kryesore e studimit të tij ishte efekti i reagimeve psikologjike të izolimit të rreptë, të tilla si në "përmbledhje nëndetëse të punës," një libër studimi i punës së nëndetëseve. Ka disa studime për çështje të familjes në luftë, kryesisht anëtarët e familjes për shkak të efekteve psikologjike të problemit të shkaktuar nga ndarja e të afërmeve, dhe marrëdhëniet

pazgjdhshme. Sepse sistemi kryesor i trajnimit është gatishmëria në punë.

Përmbajtja

Trajnimi përfshin një varietet të nevojave të veçanta ushtarake operative, duke simuluar mjedisin aktual të luftës për të mësuar dhe për të zotëruar, pajisje të ndryshme dhe situata (të tilla si mjet ajror apo marrjen e vendimeve luftë).

Përmbajtja e tyre kryesore janë: diagnoza të sjelljes psikologjike, individët, grupet e korigjimit, sjellja e vlerësimit të personelit ushtarak,

vlerësimi individual, operacionet ushtarake të lidhura me mësimdhënie dhe kërkime, dhe lloje të tjera të veçanta të punës.

Faktorët e Njeriut

Faktori njerëzor është marrëdhënia në mes njeriut dhe makinës në shumëllajshmëri të detyrave të mjedisit. Në shumë nga këto marrëdhënie, rezultatet përfundimtare të studimit të të gjithë sistemit operativ janë pjesa më e rëndësishme. Për shkak të projektimit dhe funksionimit të pajisjeve dhe sistemit efikas të trajnimit, duhet të ketë një proces të për-



familjare për të shtyrë periudhën e shërbimit të ndikimit të qëndrimit.

Psikologjia ushtarake

Psikologët ushtarakë kanë studiuar çështjen e udhëheqjes. Fokusi kryesor i hulumtimit është në kreun e fundit të përzgjedhjes, trajnimit dhe vlerësimit në aspektet e zhvillimit të çështjeve aktuale kërkimore nga e kaluara në studimin e faktorëve të mjedisit, si dhe zhvillimin organizativ .

Teknologjia ka qenë në ushtrinë amerikane për të filluar aplikimin, qëllimi i tij është të forcojë organizimin dhe efikasitetin. Kjo kërkon përdorimin e zonave jo-ushtarake të teknologjisë

Rezultatet e psikologëve në procedurat e informacionit, të drejtimit dhe mësimdhënies para-shikuara për zhvillimin e vendimit të luftës është i bazuar në të

në vetëm një numër të vogël në punë jo-luftarake. Klasa e parë e grave u diplomua në akademitë e shërbimit kombëtar. Gratë kanë shërbyer me guxim dhe në luftime në Irak dhe Afganistan. Mbi 20 përqind e kadetëve në West Point, Akademinë Detare dhe Akademinë e Forcave Ajrore janë tani gra, dhe këto numra ka të ngjarë të rriten në vitet që vijnë. Si Komandanti ashtu edhe Dekani në West Point janë drejtuar nga gratë. Shumë të tjerë janë ngritur në gradën e oficerit të përgjithshëm. Dhe gjatë gjithë rrugës, psikologët kanë lehtësuar këto përparime duke kryer hulumtime që shpërndajnë pikëpamjet e paragjykuara gjinore të kompetencës ushtarake, dhe si avokate të zëshme për të drejtat e grave për t'i shërbyer kombit të tyre në të njëjtat kapacitete,

shme seksuale dhe personat transgjitorë. Sepse një ushtri e larmishme do të përfshijë ekspertë kulturorë "të rritur në shtëpi", të cilët mund të ndihmojnë të kuptohet dimensionin socio-kulturor i luftërave të ardhshme. Psikologët, janë lojtarët kryesorë për të ndihmuar ushtrinë të modernizojë praktikën e saj të rekrutimit, dhe për të ndihmuar zhvillimin e praktikave organizative dhe kulturës pozitive për të ndihmuar ushtrinë në shfrytëzimin e plotë të larmisë së forcës së ardhshme.

Psikologjia shkolla

inovative e njerëzve nën armë

Më shumë se 15 vjet luftë kanë stresuar ushtrinë. Shkalla e vetëvrasjeve është ngritur në qiell. Çrregullimet e lidhura me stresin janë të shfrenuara midis veteraneve të luftës. Për shkak të protokolleve mjekësore të përmirësuara dhe mjeteve mbrojtëse, shumë ushtarë mbijetojnë nga plagët që do t'i kishin vrarë në luftërat e kaluara, vetëm për të përjetuar efektet afatgjata të dëmtimit traumatic të trurit ose amputimit të ekstremiteteve. Puna e psikologëve klinikë ushtarakë është thelbësore për zhvillimin e mënyrave inovative dhe efektive për të ndihmuar ushtarët e plagosur fizikisht dhe psikologjikisht të kapërcejnë dëmtimet e tyre.

Psikologjia është bërë e rëndësishme për ushtrinë në shekullin 21, nga mënyrat e shumta që psikologët tani kontribuojnë në mbrojtjen e kombit. Ka shumë më tepër. Teknologjia, në formën e avionëve me performancë të lartë, anijeve të fshehta, armëve precize, e kështu me radhë janë komponentët e nevojshëm për forcën ushtarake. Por këto sisteme, sado të përparura të jenë, në fund të fundit janë në duart e qenieve njerëzore. Kështu, psikologjia do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në zgjerimin e ushtrisë.



dhënat të përgjithshme. Ndërkohë, me zhvillimin e shkencës moderne, aplikimet kompjuterike, hulumtimet në vendimmarrje ushtarake janë gjithashtu një fazën moderne.

Femrat, armata e fuqishme në kohë lufte dhe paqe

Gjatë tre dekadave të fundit, psikologët kanë qenë të dobishëm në përpjekjet për të përmirësuar ushtrinë dhe për të rritur efektivitetin e saj. Në 1980, gratë ishin ende të ndaluara nga të gjitha punët e drejtpërdrejta luftarake në ushtri, dhe ishin të përfaqësuar

dhe me të njëjtat përgjegjësi, si burra. Kjo kohët e fundit çon në eliminimin e rregullit të përjashimit të luftimit dhe hapjen e të gjitha vendeve të punës ushtarake për gratë duke përfshirë të drejtën për trajnim elitë ushtarak.

Barrazia gjinore kusht zhvillimi

Çdo shtet për të arritur misionin e tij, në përbërjen e ushtrisë së ardhshme duhet të pasqyrojë përbërjen e popullsisë, si dhe të jetë gjithëpërfshirëse për gratë, njerëzit me orientime të ndry-

Punoi: Anjeza MUSOLLARI
Referuar: Carrie. H. KENNEDY
Nënkolonel; Ajet NUELARI

Roli i arsimimit të ushtarakëve

Lidershipi Shqiptar dhe roli i tij në ushtri

Intervistë me zotin Qetsor Orhani

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI

Si një studiu e konceptit të lidërshiptit ushtarak dhe rolit të tij në periudha të ndryshme kohore. Sa e rëndësishme ishte prania e ushtarakëve të huaj në strukturat e Forcave tona të Armatosura dhe çfarë roli luajtën ata?

Roli i arsimimit të ushtarakëve shqiptarë jashtë vendit gjithmonë ka qenë prezent por në mënyrë të veçantë ai arriti kulmin e vet mbas viteve '90, ku siç dihet me qindra ushtarakë u shpërndanë në të katër anët e globit, ashtu sikurse edhe tek ne mbërritën qindra ekspertë të tjerë ushtarakë, të cilët asistuan reformimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për ta sjellë atë në standardet e kërkuara nga partnerët tanë. Gjatë këtij procesi të gjatë fillimisht u punua me përgatitjen e liderit ushtarak pasi do të ishin pikërisht këta që do të kryenin ndryshimet thelbësore.

Kthimi i ushtarakëve nga vendet ku ata u trajnuan pa dyshim që fillimisht krijoi njëfarë konfuzioni, pasi të gjithë mendoreshin të sillnin përvojat e marra nga arsimimi i tyre në vendin ku kishin studiuar, prandaj shpesh herë ne dëgjonim të flitej për lidërshiptin ushtarak duke dhënë definicione të ndryshme rreth këtij problemi por, pavarësisht prej tyre thelbi i lidërshiptit në përgjithësi qëndron në faktin se ai është një proces influencimi tek njerëzit, për të arritur një ose disa synime, objektiva, apo për të përmbushur



një mision të caktuar pra, ai është diçka virtuale që duhet jetuar, duhet ndërë shpirtërisht dhe duhet bërë pronë e drejtuesit në përgjithësi por veçanërisht i liderit ushtarak, i cili duhet ta përmirësojë atë çdo ditë.

Ja si e përkufizon lidërshiptin Schwarzkopf, më 8 Maj 2000. "Unë ju them njerëzve se lidërshipti është një kombinim i dy gjërave i karakterit dhe kompetencës"

Krahas karakterit dhe kompetencës lideri ushtarak duhet të karakterizohet nga ndjenja e lartë e përgjegjësisë, kështu psh është

përgjegjësia e gjeneralëve të cilët duhet të sigurohen që ushtria të jetë gjithmonë e gatshme për të përmbushur misionet kushtetuese, qoftë kjo edhe për luftë nëse do të jetë nevoja.

Të gjithë njerëzit ndikohen nga ajo se ç'farë ata kanë parë, ç'farë kanë mësuar dhe me kë kanë patur të bëjnë, por veçanërisht lideri ushtarak është pikërisht ai që di të punojë me njerëzit. Disa njerëz janë gazmorë dhe buzëqeshin gjatë gjithë kohës, disa të tjerë janë seriozë. Disa liderë hyjnë në një dhomë të

mbushur me njerëz të panjohur dhe brenda pesë minutash ambientohen shumë shpejt me pjesëmarrësit, të tjerë e kanë shumë të vështirë të ambjentohen. Ka liderë të tjerë ndoshta shumë kompetent por që janë të paretshëm në situata sociale. Pavarësisht tipave dhe karaktereve të njerëzve është lideri ai që pa dalë nga vetvetja gjen mënyrën dhe rrugën se si do të inspirojë zemrat e tyre.

Trajtimi i njerëzve me drejtësi nga ana e liderit nuk do të nënkuptojë trajtimin e tyre sikur ata të ishin klone të njëri-tjetrit. Në fakt në qoftë se lideri i trajton të gjithë në mënyrë të njëjtë, mund të bëhet i padrejtë, për arsye se njerëz të ndryshëm kërkojnë gjëra të ndryshme prej tij. Në këtë kontekst liderët efektiv janë në mënyrë të mjaftueshme fleksibël për të përshtatur stilin e tyre të lidërshiptit dhe teknikat me njerëzit që ata drejtojnë. Disa vartës u përgjigjen pozitivisht me të mirë, sugjerimeve ose shtytjes miqësore, të tjerë kanë nevojë madje duan nganjëherë ngacmim me fjalë më të ashpra.

Karakterit njerëzor i liderit përbën pa dyshim aspektin më të besueshëm të një lideri të suksesshëm. Sipas gjeneral Harold K. Johnson; Komunikimi, ose aftësia për të informuar njerëzit mbi atë ç'ka pret prej tyre me fjalë të kuptueshme dhe aftësia për t'ju transmetuar atyre interesin që keni për ta, përbën çelësin për një drejtim të suksesshëm.

Stili i lidërshiptit pa dyshim që është mënyra dhe rruga e sigurimit të drejtimit, implementimit të planeve dhe motivimit të njerëzve. Sipas studiuesve ushtarakë ekzistojnë tre stile të ndryshme lidërshipti: autoritar, pjesëmarrës, dhe delegues. Në jetën e përditshme ne ndeshim në stile të ndryshme drejtimi të cilët varen nga situata, prandaj shumica e liderëve i përdorin të kombinuar të tre stilet e drejtimit, por vetëm njëri prej tyre bëhet dominant.

Pa u zgjatur shumë në trajtimin teorik unë mendoj se drejtuesi, apo lideri ushtarak, nuk duhet ta njehë-sojë veten me postin që i jepet. Ai lypset të ketë egon dhe personalitetin e tij si njeri. Mund të përmëdim shumë emra drejtuesish të cilët, megjithëse janë në pension ose nuk janë më në poste drejtuese, ende kujtohen me respekt. Kjo ndodh sepse drejtuesi me personalitet është i

prirur të krijojë marrëdhënie të tilla me vartësit e bashkëpunëtorët, që ata ta pranojnë atë jo vetëm si "autoritet zyrtar", por edhe si "autoritet shoqëror".

- Në literaturën ushtarake thuhet se, veprimi i komandantit është të "aktivizojë potencialet luftarake operacionale, për të krijuar fuqi luftarake", ndërsa funksioni i liderit është të përshtasë fuqinë luftarake, procesi nëpërmjet të cilit një komandant imponon vullnetin me sukses. Kush është roli i lidërshiptit në pikpamjen tuaj?

Roli i lidërshiptit është një nga aspektet më thelbësore të suksesit në të gjitha sferat e jetës por, më i spikatur është ky rol në Forcat e Armatosura pasi, ky rol sot me të drejtë konsiderohet si "frymëmarja" e kësaj force, pra është pikërisht ai që prodhon adrenalinën e cila ngre lart moralin e ushtarakut duke e çuar atë deri në vetësakrificim. Mjafton të kujtojmë këtu thënien brilante të ish Presidentit të SHBA-së Bill Klinton më 23 nëntor 1999 në Ferizaj të Kosovës: "Kur dolëm në tribunë, ju brohoritët për ne, sepse ju kishit qenë të shtypur, ndërkohë që ne ju qëndruam pranë. Dhe ne përdorëm fuqinë ushtarake për të mundur agresionin e Milosheviçit. Ne e fituam luftën. Por, dëgjoni, vetëm ju mund të fitoni paqen".

Është pikërisht "Fuqia ushtarakë" siç e quan Klintoni, pjesë shumë e rëndësishme e fuqisë së një shteti, shumë e rëndësishme për fitoren e luftës, është pikërisht roli i lidërshiptit ai që ngre lart zemrat e njerëzve, Klintoni e quan, "ne ju qëndruam pranë", që historikisht ka qenë një faktor shumë më i fuqishëm, për atë që Klintoni e quan "ne e fituam luftën", që në një farë mënyre do të thotë se Kosova, por jo vetëm, asnjëherë në historinë e saj nuk kishte patur aleatë kaq të fuqishëm në anën e saj. Në këto kushte, të mos arrish të fitosh paqen, për lidërshiptin është një mëkat i madh historik, është shpërdorim i një rasti të tillë që një kombi e një popull nuk i jepen ndoshta asnjëherë në historinë e tij.

-Në korrik të vitit 1943 krijohet Shtabi i Përgjithshëm me lidërshipt ushtarak nga kahe të ndryshme, me lidërshipt ushtarak të spikatur nga orientimi politik i vendit.

A ka qenë parim për liderat e ushtrisë shqiptare ky koncept?

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare lidërshipti i kohës filloi t'i jepte ushtrisë formën organizative të një ushtrie brenda shtetit. Duke marrë postin e Komandantit të Përgjithshëm, Hoxha luajti rolin e një kryetari të shtetit, ndërsa Moisiu atë të ushtarakut të mirëfilltë në drejtimin teknik ushtarak.

Spiro Mojsiu, ishte një figurë e shquar ushtarake e kohës. Ai qëndroi në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nga muaji maj i vitit 1944 deri në gusht të vitit 1946. Bedri Spahiu, Dali Ndreu, etj. kishin qenë ushtarakë të karrierës, ata ishin arsimuar në shkolla ushtarake jashtë vendit si psh Dali Ndreu në Itali e Abaz Kupi kishte shërbyer në armën e xhandarmërisë gjatë kohës së Zogut me gradën e majorit.

Jo vetëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ku roli i lidërshiptit ushtarak ka qenë i pa diskutueshëm por edhe më herët vendit tonë nuk i kanë munguar asnjëherë lidera të suksesshëm të cilët kanë qenë të arsimuar në akademitë ushtarake nga më të njohurat për kohën.

Fillimisht u përkrahën ushtarakët e arsimuar jashtë vendit të cilët mbështetën Luftën Nacionalçlirimtare dhe morrën pjesë intensive në organizimin e saj, por ajo që dëmtoi më rëndë ushtrinë tonë erdhi mbas çlirimit të vendit, ku u denigruan thuajse të gjithë ata që kishin studiuar jashtë vendit dhe në Forcat e Armatosura hyri fryma e partisë në pushtet e cila politizoi çdo qelizë të ushtrisë, duke shmangur në mënyrë të qëllimshme rolin e lidërshiptit ushtarak, madje më vonë me heqjen edhe të gradave ushtarake, ushtria u shndërua në një organizim të madh politik ku predominonte vija e partisë.

Në periudhën kur BS e udhëhiqte Stalini u hodhën bazat e bashkëpunimit dypalësh politik, ideologjik ushtarak, ekonomik e kulturor. Stalini i dha ndihma ekonomike të konsiderueshme Shqipërisë, mbështeti bazat e ekonomisë, fuqizoi ushtrinë shqiptare, dha bursa të shumta për arsimimin e lidërshiptit ushtarak si dhe solli këshilltarë të lartë në thuajse gjithë pikat kyçe të drejtimit të ushtrisë dhe të shtetit.

Në periudha të ndryshme, si ajo e pavarësisë, ushtarakë holandezë (në tetor 1913) erdhën në Vlorë dhe dhanë kontributin e tyre në risstrukturimin dhe përgatitjen e xhan-

dermarisë shqiptare, kurse në qeverinë e Ahmet Zogut nga Austria erdhi kolonel Gustav Fon Myrdac për të drejtuar shtatmadhorinë. Çfarë impakti krijuan ata dhe cilat ishin tiparet dalluese të lidhshimit ushtarak në periudhën 1912-1944.

Në këto vite, në Ushtrinë Shqiptare drejtuan kryesisht ushtarakë shqiptarë që ishin përgatitur në Turqi. Kështu psh në kohën e shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali caktoi si Ministër të luftës Mehmet Pashë Dërrallën, një Gjeneral i arsimuar në Akademinë e Shtatmadhorisë në Stamboll dhe që kishte arritur funksione të larta në ushtrinë osmane. Ishte një nga mbështetësit e tij dhe një ndër inisiatorët për Pavarësinë e Shqipërisë, ai kishte qenë komandant i Forcave Ushtarake të Lidhjes së Prizrenit.

Po kështu pranë Dërrallës, i pari Shef i Shtabit të Përgjithshëm u caktua Major Ali Shefqet Shkupi, për të organizuar ushtrinë si kryetar i Shtatmadhorisë, ai kishte përfunduar në vitin 1905 studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Stamboll, me gradën kapitene shtatmadhorie.

Shumë ushtarakë të huaj punuan në Shqipëri pas Shpalljes së Pavarësisë me 1912, mjafton të kujtojmë këtu; grupin e ushtarakëve holandezë të kryesuar prej Kolonelit De Veer dhe majorit Thomson, të cilët ndihmuan në ristrukturimin dhe përgatitjen e xhandarmërisë shqiptare. Leon de Chilly, hyri në shërbim të Ushtrisë shqiptare që në vitin 1913, ndërsa kapiteni austriak Hasler shërbente si instruktor që prej vitit 1914.

Të gjitha qeveritë shqiptare në vitet 1920-1939 e kanë vlerësuar shumë lart rolin e lidhshimit ushtarak si mjaft të rëndësishëm në situatat e vështira që kalonte vendi ynë në këto kohë shumë të turbullta.

Po kështu Ali Riza Kolonja i cili drejtoi ushtrinë në vitin 1920, me gradën gjeneral, u zgjodh ministër lufte nga qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Ai ishte ushtarak karriere, shkollën ushtarake e kish mbaruar në Stamboll dhe Akademinë e Shtatmadhorisë në Gjermani.

Ministri Selahudin Said Shkoza, drejtoi në periudhën 1920-1921 me gradën kolonel, ishte arsimuar në Stamboll. Ai hyri në historinë e Ushtrisë Shqiptare jo vetëm si

një ministër mbrojtjeje, por edhe si reformator i shquar. I ardhur nga Ushtria Turke, ai përshtati për kohën ato ligje që ishin të domosdoshme për të rregulluar marrëdhëniet e shtetit me ushtarakun.

Po kështu pa u zgjatur mund të përmendim; Mustafa Maksutin, ushtarak me gradën major i arsimuar në Stamboll, Zija Dibra, i arsimuar në Stamboll, Shefik Kosturi, një nënkolonel i arsimuar në Turqi, Ismail Tatzati, një kolonel i arsimuar në Stamboll, Mustafa Aranitasi, kolonel i arsimuar në Stamboll si dhe Kasëm Qafëzezi, kolonel i arsimuar në Stamboll e Vjenë, Xhemal Aranitasi, kishte gradën gjeneral, ishte arsimuar në Stamboll. Duke parë në prizmin historik, por edhe në atë aktual në drejtim të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes, mund të themi se, thelbi i lidhshimit është aftësia për të dalluar dhe për të përdorur ato modele motivacionale të lidhura që i nxisin të tjerët, pra t'i bësh njerëzit që, vullnetarisht, të bëjnë gjëra që, ndryshe, nuk do t'i bënin, duke i harmonizuar këto modele me misionin sipas kohës vendit dhe subjektit.

-Nisur nga kjo cili ishte roli që luajti lidhshimi ushtarak në periudhën e Monarkisë Shqiptare 1928-1939?

Në periudhën e Monarkisë u rrit prania dhe roli oficerëve organizatorë, në vitin 1927, ardhja e misionarëve ushtarakë italianë përcaktoi ndryshimin e sistemit ekzistues, të kalimit në ushtri të tipit të rregullt, të kohës. Ushtria u nda në katër komanda: Komanda e Artilerisë, Komanda e Xhenios, Komanda e Marinës së Luftës dhe Komanda e Gardës. Futja e pajisjeve dhe e armatimeve të reja, rriti fuqinë luftarake të Ushtrisë Shqiptare. Në këtë hark kohor ajo u plotësua me një varg rregulloresh, të cilat ndikuan ndjeshëm në rregullimin e veprimtarisë së përditshme të saj.

Në vitet 1925-1928, pranë Ushtrisë erdhën afro 240 këshilltarë ushtarakë italianë, nën drejtimin e kolonelit Alberto Pariani. Pas punës në Shqipëri, Pariani u bë më vonë gjeneral korparmarte dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë italiane.

Më 20 maj të vitit 1922, major Myrdac u emërua organizator dhe njëkohësisht inspektor i përgjithshëm i Ushtrisë shqiptare, që ishte në riorganizim e sipër. Në këtë post

gjeneral Myrdac vijoi të punonte deri në fillim të muajit prill 1939, kur Ushtria shqiptare pushoi së vepruari dhe vendi u pushtua nga agresioni fashist. Gjatë zhvillimit të operacionit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare për çlirimin e kryeqytetit të vendit, forcat partizane kapën dhe arrestuan gjeneral Myrdacin. Ai iu dha për gjykim gjyqit special të luftës, që u zhvillua në Shqipëri pas Çlirimit të saj, në vitin 1945, që përcaktoi dhe fatin e tij. Gjenerali Myrdac shërbeu për tetëmbëdhjetë vjet në Ushtrinë shqiptare, 1922-1939 dhe 1943-1944.

Një tjetër ushtarak austriak, që erdhi në Shqipëri për të ndihmuar në organizimin dhe përgatitjen profesionale të Ushtrisë shqiptare të viteve 1928-1944, ishte dhe Herman von Kirchneri, ose siç njihet ndryshe baroni Kirchneri. Por ky ushtarak austriak ndryshe nga atdhetari i tij Myrdac nuk pati fatin e tij tragjik.

-Çfarë risie solli lidhshimi ushtarak pas çlirimit të vendit?

Mbas çlirimit të vendit, ashtu sikurse folëm pak edhe në fillim të intervistës, formimi i ushtarakëve shqiptarë u bazua kryesisht në arsimimin e tyre në akademitë e ish BS deri sa u hodhën bazat për krijimin e një serie shkollash ushtarake të cilat luajtën pa dyshim rolin kryesor në përgatitjen e lidhshimit ushtarak me vlera ushtarake të pa diskutueshme për vendin, por që në prizmin doktrinar nuk kishin asnjë lidhje me strukturën që pritej të ndërtohej në vend pas shëmbjes së komunizmit. Lufta e Ftohtë ashtu sikurse në shumë vende të lindjes sidomos mbas daljes nga Traktati i Varshavës çoi në bunkerizimin e vendit. Organizimi i fortifikimit ishte një punë kolosale, me shpenzime të jashtëzakonshme, pjesë e logjikës izoluese të regjimit. Ajo solli degradimin gradual të ish-Bashkimit Sovjetik, i cili kishte konsumuar mjaft nga energjitë e tij të brendshme, resurset ekonomike e teknologjike, kishte brejtur brënda tij gjithë strukturat si dhe kishte dëmtuar në planin e jashtëm aleancat satelitore. Këtë periudhë H. Kisinger e karakterizon me fjalët: "Kurrë ndonjë fuqi tjetër botërore nuk është shpërbërë tërësisht dhe kaq shpejt, pa humbur në luftë"

Edhe mbas çlirimit të vendit ishte Mehmet Shehu i cili ishte arsimuar në kolegjin e Napolit dhe Akademinë "Voroshilov". Ai ishte Kryeministri

me jetëgjatë i Shqipërisë deri në ditën që u vetvra, që shërbeu edhe si Ministër i Mbrojtjes, 1974-1981, po kështu edhe Kadri Hazbiu, si ministër në vitet 1982-1991, ishte arsimuar në Shkollën e Lartë të Sigurimit në ish-Bashkimin Sovjetik.

Shqipëria është anëtarësuar në NATO, duke realizuar fitoren më të madhe të politikës shqiptare, por në këtë arritje një kontribut të madh kanë dhënë edhe FA të vendit, të cilat "de fakto", me praninë e tyre në misionet ishin prej kohësh pjesë e NATO-s, para se vendi të bëhej "de jure" i tillë. Usharakët shqiptarë kanë një përgatitje po aq të lartë sa ajo e vendeve të tjera të NATO-s.

-Si ka evoluar historia e lider-shipit ushtarak shqiptar dhe roli i tij në organizmin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura parë në këndvështrimin e ditëve tona?

të këtij lloji, ka qënë mungesa e eksperiencës. Misionet e para paqëruajtëse e filluan përgatitjen në vitin 1995, kur pjesa më e madhe, ose gati gjithë drejtuesit ushtarakë ishin të arsimuar vetëm në shkollën shqiptare ushtarake, në një shkollë vërtet me karakteristika të spikatura, por krejt me koncepte doktrinale të tjera. Në ato kushte kërkohet që të përballohej njëkohësisht si ngarkesa për përgatitjen dhe realizimin e misioneve të caktuara, por edhe të kaloheshin vështirësitë e reformimit të vazhdueshëm të ushtrisë. Në kujtesën tonë do të ngelen të paharuara fjalët e ish Presidentit Amerikan George Bush, i cili në Samitin e Bukureshtit me 3 prill 2008, tha se: "tre vendet ballkanike e meritojnë ftesën për t'u anëtarësuar, për rrugën e vështirë të reformave që

aderuar. Anëtarësimin në Bllokun e Lindjes u ndërpre në vitin 1968, kur Bashkimi Sovjetik pushtonte ushtarakisht një vend anëtar të Traktatit të Varshavës, Çekosllovakinë. Pas vitit 1968 Shqipëria ishte një vend jashtë aleancave të mëdha e brenda izolimit të saj të mbushur me bunkerë në gjithë territorin e vogël, me ekonominë që asfiksohej dhe me liritë demokratike që gjithnjë e më shumë mungonin. Ndonëse gjatë 95 viteve ekzistencë si shtet, vetëm në 13 vite Shqipëria bëri pjesë në një aleancë ushtarake, por neutraliteti nuk hodhi kurrë rrënjë në ndërgjegjen e shqiptarëve. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Kinën, Shqipëria nuk bëri pjesë në asnjë aleancë, deri në fillimin e viteve 90, kur shpalli se dëshiron të integrohet në NATO. Vendimi i vendeve anëtare të NATO-s, për të ftuar Shqipërinë i dha asaj mundësinë të finalizojë ato përpjekje dhe atë aspiratë mbarëshqiptare për anëtarësim në NATO. Ende, publiku shqiptar mbetet në treguesit më të lartë të mbështetjes së anëtarësimin të vendit në NATO dhe pjesëmarrjes në misionet të drejtuara nga NATO jashtë rajonit. Sondazhet zyrtare nxjerrin një mbështetje rreth 89% të shqiptarëve për NATO.

Që nga anëtarësimi zyrtar i Shqipërisë në NATO ka nisur të zbatohet plani i integritimit që nënkupton reformimin e thellë të sektorit të sigurisë e mbrojtjes me qëllim ndërveprimin e plotë me NATO. Pjesë e këtij plani është paketa me 49 objektiva force të cilat janë marrë përsipër nga FASH si kapacitete operacionale të cilat vihen në dispozicion të NATO për misionet aktuale dhe të ardhshme. Thelbin e tyre e përbën "Grup batalioni i lehtë" i cili përfaqëson një "Task Forcë" me përbërje rreth 1000 veta. Në thelbin e saj është një batalion këmbësorie i lehtë, i motorizuar, i mbështetur edhe me njësi më të vogla (nivel kompanie apo toge) për shërbime zbulimi, mbështetje me zjarr, mbulim nga ajri, shërbim policie ushtarake etj.

Aktualisht, FASH marrin pjesë në misionin ISAF të NATO në Afganistan në disa rajone si Herat (me kontingjentin italian), Kabul (me kontingjentin turk), Kandahar (në misionet speciale me kontingjentin amerikan) etj.



Ishte partneriteti midis Shqipërisë dhe NATO-s si dhe me vendet anëtare të saj, që rriti dhe intensifikoi bashkëpunimin politik dhe ushtarak, kontribuoi në angazhimin drejt parimeve të demokracisë dhe rritjes së stabilitetit, transparencës në buxhetin e mbrojtjes, thellimin e kontrollit demokratik në Ministrinë e Mbrojtjes, planifikimin e përbashkët, stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Rol të veçantë luajti dhe pjesëmarrja direkte e ushtarakëve si në arsimim por veçanërisht pjesëmarrja direkte në operacione të përbashkëta duke bashkëvepruar me forcat e NATO-s në fusha të tilla si paqëruajtja, operacionet e kërkim-shpëtimit dhe ato humanitare. Një nga vështirësitë e drejtimit në përgatitjen e trupave

kanë përshkruar, se, kanë ndërtuar shoqëri të lira dhe demokratike e do të japin kontributin e tyre në NATO" Pjesëmarrja në Aleancën më të madhe të të gjitha kohëve i dha liri më të madhe shqiptarëve, iu dha emër më të nderuar dhe lidershit të asaj kohe dhe atij aktual më shumë besim tek e ardhmja.

Shqipëria, një vend neutral gjatë Luftës së Parë Botërore, sido që neutraliteti i saj nuk u respektua nga palët ndërluftuese, megjithëse nuk hyri në aleanca, nuk krijoi një traditë neutraliteti. Nga viti 1945 deri në themelimin e Traktatit të Varshavës, më 1955, Shqipëria nuk ishte anëtare e asnjë Aleance. Traktati i Varshavës është aleanca e vetme ushtarake ku Shqipëria ka

Akademia e Forcave të Armatosura

Programi Ekstra-Kurrikular, risi për studentët e Bachelor-it

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë, nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur oficerë më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë, por është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të afruar talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndër-tuar një karrierë si profesionistë të arsimit.

Në prag të çeljes së vitit të ri akademik për herë të parë AFA realizoi Programin Ekstra-Kurrikular me studentët e Bachelorit të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Koha në të cilën ky Program u zhvillua ishte e vendosur prej datës 7-30 shtator 2021. Qëllimi i këtij programi është synimi dhe orientimi i studentëve drejt njohjes me kulturën, historinë e vendit, përvetësimin e njohurive mësimore dhe stërvitore në terren.

Konkretisht, Programi Ekstra-Kurrikular konsiston në zhvillimin e stërvitjes fushore-ujore në Pashaliman, stërvitjen alpine, vizita në Muzeun Kombëtar dhe Bunk'Art në Tiranë, Kalanë e Beratit, Shkodrës, Monumentet Historike si Varri i Skënderbeut në Lezhë, vizitë në Amfiteatrin e Apolonisë, si dhe vizitë në Komandat e Forcave të Armatosura. Java e parë nga data 7 deri më 10 shtator përfshinte alpinizmin, ku studentët do të mësonin ndërtimin e teleferikut, zbritjen prej tij dhe llojet e lidhjeve alpiniste. Java e dytë 13-17 shtator konsistonte në vizitat mësimore vajtja në kalanë e Beratit dhe në Repartin Ushtarak nr.1030 në Poshnje. Vizitë në monumentin

Programi afron dhe orienton studentët drejt njohjes së kulturës dhe historisë së vendit, përvetësimit të njohurive mësimore dhe stërvitore në terren

e Skënderbeut në Lezhë dhe kalanë e Rozafës në Shkodër, më pas në Repartin Ushtarak nr.1010 në Vaun e Dejës, për t'u ndalur edhe në Apoloni dhe Bazën Ajrore të Kuçovës. Java e tretë filloi ditën e diel, më datë 19 deri më 24 shtator, objektivi kryesor i kësaj jave ishte marshimi dhe përgatitja fizike që u përqendrua më së shumti në stërvitjen ujore në Bazën Detare të Pashalimanit, Vlorë. Java e katërt dhe e fundit filloi, më datë 27-30 shtator, këto ditë studentet vizituan Muzeun Kombëtar dhe Bunk'Art-in, kalanë e Krujës, Forcat Ajrore dhe Policinë

Ushtarake.

Për t'u ndalur në detaje dhe për të mësuar më shumë rreth Programit Ekstra-Kurrikular, idesë së krijimit, stërvitjeve që u zhvilluan apo dhe vendeve që vizituan studentet, biseduam me drejtuesit në Departamentin e Formimit Ushtarak.

Kolonel Elton Bregu, shef i Departamentit të Formimit Ushtarak u shpreh se "jeta studentore nuk është vetëm brenda klasave apo stërvitjeve që zhvillohen, prandaj për t'i dhënë më tepër mundësi rritjes së frymës në grup, thellimit të dijeve dhe aftësive të tyre në



Vizitë mësimore në Berat (13.09.2021)



Apoloni, Fier (1709.2021)

fusha të ndryshme, ne menduam të realizonim "Programin Ekstra-Kurrikular". Si pjesë e programit u menduan aktivitete të ndryshme si kursi i alpinizmit për të rritur aftësitë e tyre fizike në ngjitjet dhe zbritjet malore gjithashtu dhe stërvitja ujore në Bazën Detare të Pashalimanit."

Gjatë këtyre ditëve studentët janë shoqëruar nga personeli drejtues i përbërë nga Major Bleard Vuçaj, Kapiten Endri Deda, Togere Gliserda Nekaj dhe Reshter Blertjan Maksutaj.

Togere Gliserda Nekaj, e cila është pedagoge përgjegjëse në grupin komandues në Departamentin e Formimit Ushtarak, shprehet kështu: "Në këtë vit menduam të bënim diçka ndryshe për të rritur nivelin profesional dhe intelektual të studentëve tanë, u mendua një Program Ekstra-Kurrikular, ku brenda tij ishin të përfshirë një sërë aktivitete, bazuar në mendimet dhe eksperiencat e stafit të DFU-së."

Në brendësi të ditëve në Bazën Detare të Pashalimanit, Vlorë (stërvitja ujore)

Studentet e Bachelor-it, pasi u nisën nga garnizoni "Skënderbej", u dislokuan në Bazën Detare të Pashalimanit, stërvitja zgjati 5 ditë. Pas ndërtimit të fushimit, ditën e hënë vijuan me përgatitjet fizike e më pas me njohjen në ambientet e Bazës Detare, Flotiljen dhe Qendrën e Zhytjes. Pasdite u bë ndarja

në grupe, për të kuptuar aftësitë notuese të studentëve: grupi më i mirë, mesatari dhe më pak të mirë. Qëllimi kryesor është që studentët të fitojnë aftësi të mira notuese edhe ata që i kanë t'i përforcojnë dhe përmirësojnë. Dita e dytë iu kushtua njohjes së ambienteve dhe funksionimit të anijeve në drejtimin e komandantëve, të ndarë në grupe studentët morën një shpjegim të detajuar për mënyrën e funksionimit të tyre. Pas realizimit të lëvizjeve me skaf, kur mbërritën në fushim, studentët u pajisën me veshjet e nevojshme për të bërë zhytjet në det. Gjithashtu gjatë ditës së dytë vizituan Orikun, qytetin antik 2500 vjeçar. Dita e 3-të, gara ndërmjet studentëve ishte dhe pjesa më kulmore që përfshinte disa disiplina, e para ajo e notit me një distancë të përcaktuar, disiplina e dytë ishte zvarritja dhe e disiplina e tretë vrapit me pajime. Gjithsej ishin 6 skuadra që konkurronin me njëra-tjetrën dhe fitimtare dolën 2 prej tyre. Për të rritur frymën e konkurrimit midis tyre ishte vendosur dhe një shpërblim. Dy skuadrat fituese bënë një vizitë në fshatin Tragjas i Vjetër një fshat i pabanuar, por i bukur e me histori, duke e bërë akoma më interesant për t'u vizituar. Ditën tjetër duke ndjekur rutinën mëngjesit realizuan marshimin sportiv, ngjitjen e Karaburunit deri në Gjirin e Arushës, ose si njihet në hartë gjiri i Britanit. Ditën e fundit u bë kthimi drejt garnizonit "Skënderbej" me

autokolonë, kjo ishte eksperiencia e parë e fushimit ujor në Pashaliman. Stërvitjen ujore e ndoqi dhe Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai i shoqëruar nga Shefi i Departamentit të Formimit Ushtarak, kolonel Elton Bregu.

Një element që vlen të përmendet është bashkëpunimi jo vetëm në Bazën Detare të Pashalimanit por me secilën nga njësitë të cilat bënë të mundur realizimin e Programit Ekstra-Kurrikular në tërësi. Pikërisht kjo frymë bashkëpunimi që vihet re dukshëm mes ushtarakëve është ajo që i diferencon.

Janë 56 studentë të cilët u bënë pjesë e Programit Ekstra-Kurrikular, ata arritën që të plotësonin me sukses objektivat kryesore, forcimin e frymës së grupit dhe thellimin e njohurive në fusha të ndryshme. Duke u përmbajtur masave të Covid-19, mbajtjes së distancës, vendosjes së maskës dhe mbi të gjitha duke u vaksinuar, arritën të realizonin në mënyrën më të mirë të mundshme secilën "sfidë" malore, fushore apo ujore.

Në lidhje me këtë eksperiencë studentja Alueda Vata tha për gazetën "Ushtria" se "ishte diçka interesante e pa përjetuar më parë, duke filluar që nga hedhjet prej kullave, e cila ishte një eksperiencë e bukur dhe e re. Do të dëshiroja që ky program të përsëritej sërish dhe në vitet e ardhshme. Gjithçka shkoi shumë mirë, sidomos në Pashaliman".

Ndërsa një tjetër student, Erisel Mehmeti thotë se "ishte një program shumë i mirë, me një shumëllojshmëri aktivitete, si njohja e reparteve të tjera, vizitat nëpër kala, por sfida e Pashalimanit, ku u ndamë në grupe, mbetet më e veçanta sepse kështu doli në pah dhe bashkëpunimi mes nesh. Ndoshta shtimi i disa aktiviteteve të tjera do të ishte një mundësi e mirë për ne."

Ky program është vetëm burim dijesh, një gërshtetim i historisë dhe kulturës ushtarake, i stërvitjeve ujore dhe marshimeve, i lojërave sportive dhe përgatitjes profesionale. Duke marrë shkas nga këto ndërthurje, përsëritja e tij do të jetë gjëja më e mirë për brezat e ardhshëm të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.



FORCAT SPECIALE KY ASET KOMBËTAR

Heronjtë e heshtur për të cilët flet vetë historia

Batalioni i Forcave Speciale është krijuar me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes Nr. 2, datë 16 tetor 1998, ndërsa aktiviteti i shtabit të këtij reparti ka filluar në shkurt 1999 me katër Grupe Speciale. Batalioni i Forcave Speciale është njësi më speciale e FA shqiptare me qëllim realizimin e detyrave më të komplikuar, më të vështira dhe më të rrezikshme që mund t'i ngarkohen një njësie operationale, ku përfshihen operatione

speciale nga toka, ajri dhe deti. Vendi i parë i dislokimit të njësisë ishte në rajonin e Farkës, meqënëse aty ndodheshin të dislokuar edhe helikopterët e Forcave Ajrore të cilët do të mundësonin përdorimin e këtyre forcave me shpejtësi dhe efikasitet të plotë.

Ndërsa nga marsi i vitit 2008, venddislokimi i Batalionit të Forcave Speciale është në garnizonin e Zall-Herrit (ish Regjimenti Komando), një terren i cili mundëson plotësimin e të gjithë nevojave të

mbështetjes së stërvitjes së këtyre forcave.

Aktiviteti i këtij reparti daton prej 24 shkurtit të vitit 1999 dhe është i përbërë nga Shtabi dhe 4 grupe speciale. Komandanti i parë i Batalionit Special ka qënë Kolonel Hysen Ymeri një nga zbuluesit më të mirë të ushtrisë.

Më 3 gusht të vitit 1999 u morr në dorëzim flamuri luftarak i Batalionit.

Për realizimin e detyrave u fillua me përzgjedhjen e personelit i cili



Batalioni i Forcave Speciale është njësi me speciale e FA shqiptare me qëllim realizimin e detyrave më të komplikuar, më të vështira dhe më të rrezikshme që mund t'i ngarkohen një njësie operacionale, ku përfshihen operacione speciale nga toka, ajri dhe deti.

në fillimet e tij trajnohej nga instruktorë turq të Forcave Speciale. Me rritjen e kapacitetve të këtij batalioni pas viteve 2007, kurset e FS filluan të realizoheshin nga vetë efektivet me cilësi të veçanta si durimi i kalitur, precizion në qitje dhe saktësia taktike dhe teknike. Ky personel përzgjidhet nga të gjitha repartet e Forcave të Armatosura (FA), në bazë të dëshirës dhe vullnetit të tyre. Mbas përzgjedhjes, ky efektivi nënshtrohet disa testeve të ndryshme 3-javore dhe kjo për të përfituar të drejtën për të vazhduar Kursin Bazë të Forcave Speciale, dhe vetëm ata që arrijnë të mbarojnë me sukses këtë kurs mund të bëhen pjesë e trupës të Forcave Speciale, dhe sipas specialitetit dhe aftësive individuale ata bëhen pjesë e Kompanive të Antiterorit, Kompanisë Speciale Alpine, Parashutiste, Kompanisë së Zhytjes së Luftimit.

Prej krijimit të saj dhe në vazhdim njësitë e Forcave Speciale kanë realizuar detyra të ndryshme në bashkëpunim me FS e NATO-s si

brenda dhe jashtë vendit. Ato kanë marrë pjesë në misione paqeruajtëse si në Bosnje-Hercegovinë, Afganistan, Irak, Çad, Kandahar etje.

Në të gjitha misionet FS Shqiptare kanë arritur suksese me përkushtim të plotë, duke sakrifikuar dhe jetën: në datën 20 shkurt të vitit 2012 ra në krye të detyrës Dëshmori i Atdheut, Kapiten Feti Vogli, komandat i grupit të parë special të Kompanisë së Zhytjes, në Daman të Afganistanit, dhe ku u plagos nëntetari Aleksandër Peçi.

Dërgimi për herë të parë i një anëtari të FS në Shtabin Qëndror të Forcave Speciale të NATO-s në Mons, Belgjikë si dhe krijimi i dokumentit strategjik për FS, në dhjetor të vitit 2011, me urdhër të MM dhe të SHSHP solli njohjen e Forcave Speciale në komunitetin e FS të NATO-s dhe rritjen e kapaciteteve të saj.

Operacionet e para të BFS-së kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999 si pjesë e monitorimit të kufirit.

Në vitin 2002 misionet e BFS

kanë konsistuar në dhënien e ndihmës dhe largimin e banorëve nga zonat e përmblytura, evakuimet e njerëzve, rruajtja e objekteve të rëndësishme të veçantë gjatë procesit zgjedhor, operacioni 6-mujor për kërkimin e viktimave të tragjedisë së 9 janarit të vitit 2004, përgjatë vijës bregdetare Vlorë-Himarë, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, armëve.

Misionet Luftarake:

Për herë të parë që pas luftës së II Botërore në historinë e Forcave tona të Armatosura në korrik të vitit 2010 u nis nga BFS misioni i parë luftarak "EAGLE-1" në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, për kërkimin dhe zbulimin e terroristëve që vepronin në atë zonë. Dhe më pas do vazhdonte misionin e saj krahas ushtrive aleate të NATO-s.

KOMANDANTËT NË VITE:

*Kolonel Hysen Ymeri.
Tetor 1998 — Janar 2001.
N/Kolonel Xhevair Abdia.
Janar 2001 — Janar 2002.
N/Kolonel Bashkim Balla.
Maj 2002 — Dhjetor 2005.
Kolonel Rruzhdi Kuci.
Dhjetor 2005 — Dhjetor 2006.
Kolonel Dritan Demiraj.
Janar 2007 — Nëntor 2013.
N/Kolonel Gazim Hoxha.
Nëntor 2013 — Dhjetor 2015.
Kolonel Eklend Dauti.
Janar 2015 — Korrik 2017.
Kolonel Ilirjan Dauti.
Korrik 2017 — Janar 2019.
N/Kolonel Ramadan Karakushi
Janar 2019 — Maj 2020
N/Kolonel Ajet Jata
Shtator-2020 dhe në vazhdim*

MISIONET PAQËRUAJTSE

Në gusht të vitit 2002 deri në shtator të vitit 2004 batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në 4 misione paqeruajtëse në Kabul të Afganistanit nën komandën e ISAF.

Nga viti 2002 dhe 2003 pjesëtarë të shtabit të batalionit (2 oficerë dhe 1 n/oficer) kanë marrë pjesë në tre misione paqeruajtëse në Bosnje- Hercegovinë në shtabin e SFOR.

Nga viti 2005 deri në vitin 2008 çdo 6 muaj dërgon dy grupe speciale në mënyrë të rregullt që të kryejë detyra në Mosul (Irak).

Me detyra ngritje postblloqesh, kontroll banesash arrestime terroristësh me forcat amerikane, shoqërimi personalitetesh të larta me eskorta të përforcuara.

Dhe me mbi 12 misione të kryera me sukses nga efektivi i Batalionit.

Në vitin 2008 ka marrë pjesë me një mision në Çad, me një grup në përbërje të forcave franceze.

Nga 26 prill të vitit 2017- Shkurt 2020 nga Batalioni i Forcave Speciale janë kryer 6 misione KFOR, Kosovë.

Batalioni i Forcave Speciale nga 1 Mars 2021 funksionon me një shtab që kryen funksionet nga S-1 deri në S-7 dhe me 3 Kompani të Aksioneve Direkte (Speciale) të përbëra nga 4 Grupe Speciale me nga 12 efektive por edhe një minishtab kompanie.

Ky Ristrukturim ka pasur si qëllim mirëmenaxhimin dhe mirë alokimin e burimeve në mbështetje të Operacioneve speciale në përputhje me Misionin dhe detyrat e Regjimentit të Operacioneve Speciale, për të përmbushur misione të Operacioneve Speciale gjatë të gjithë spektrit të operacioneve Ushtarake në Kudër të NATO por edhe operacione në interes të Sigurisë Kombëtare.

Dinamika e shpejtë e zhvillimeve globale si dhe kërcënimet e reja Asimetrike dhe të karakterit "Hibrid" kërkojnë një përgjigje të përshatshme me kërcënimet me forca të mirëtrajnuara, të ndërveprueshme si në spektrin Ushtarak por edhe me agjensitë e sigurisë për të identifikuar, parandaluar shkalëzimin, si dhe neutralizimin e kërcënimeve të ndryshme ndaj sigurisë.

Forcat e operacioneve Speciale janë "thembra e Akilit" në Operacionet aktuale të NATO-s, pasi ato vlerësojnë dhe i paraprijnë me përgjigje konkrete kërcënimeve dhe rrisqeve të sigurisë.

"Strategjitë pa taktikat janë rruga më e ngadaltë drejt fitores. Taktikat pa strategji janë zhurmë përpara humbjes".

Operacionet speciale mund të kryhen në të gjitha fazat e spektrit të plotë të operacioneve, të cilat përfshijnë angazhimin e forcave gjatë kohës së luftës, në kohë paqeje dhe krizash, si dhe dhe në mbështetje të/ose pjesëmarrje në Operacionet Ndërkombëtare të Stabilitetit.

Misionet e Operacioneve Speciale të zhvilluara brenda vendit duhet janë të specifikuara dhe të autorizuar në legjisllacionin e Republikës së Shqipërisë për përdorimin e Forcave të Armatosura. Doktrina e Forcave Speciale e miratuar në dhjetor 2017 përcakton principet themelore nëpërmjet të cilave Forcat e Operacioneve Speciale zhvillojnë operacione për arritjen e objek-



tivave strategjike dhe përmbushjen e synimeve politiko-ushtarake.

Në ditën e tyre të krijimit 23 vite më parë Forcat Speciale do merrnin mesazhe urimi, mirënjohjeje dhe falenderimi dhe nga Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Prof. Asoc. Bajram Begaj, si dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji.

Gjeneralmajor Begaj në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni vlerësoi përkushtimin, ndjenjën e lartë të përgjegjësisë që kjo njësi ka treguar ndër vite, duke përfaqësuar vlerat më të mira të Forcave tona të Armatosura, në operacionet brenda e jashtë vendit krahas aleatëve të NATO dhe partnerëve të tjerë.

"Mirënjohje të përhershme për kapiten Feti Voglin, ushtarakun që u bë kurora e krenarisë duke i dhënë njësisë tuaj statusin e batalionit të heronjve. Kjo njësi nuk do të ishte

këtu sot, pa ndihmën e partnerëve tanë strategjike dhe në mënyrë të veçantë SHBA, të cilët kanë rritur dhe përmirësuar kapacitetet operacionale luftarake, falë mbështetjes me instruktorë të Forcave Speciale në fushën e trajnimit të shtabit dhe trupave para dislokimit në zonat e rrezikut, si dhe në operacionet luftarake në Afganistan..." – u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.

Gjeneral brigade Arben Kingji në fjalën përshëndetëse do shprehej:

"Bereta vishnje është një simbol ekselence dhe kurajoje, ndaj gjej rastin që në emër të Komandës së Forcës Tokësore të shpreh urimet më të përzemërta për të gjithë efektivet të këtij batalioni.

Përgjatë gjithë këtyre viteve, Forcat Speciale kanë krijuar imazhin më pozitiv të Forcave të Armatosura të RSH, duke treguar kurdoherë profesionistin elitare dhe të sakrificës që nuk kanë kursyer as gjakun dhe as mundin për të justifikuar emrin e tyre dhe përmirësuar imazhin e vendit dhe FARSH.

Ky 23-vjetor ju gjen me një historik të pasur angazhimesh në zonat luftarake dhe bashkëpunimesh brenda dhe jashtë vendit me partnerët tanë të NATO-s, ku të gjithë ju pjestarë aktual dhe 'ish-specialsa', keni demonstruar një nivel të lartë përgatitjeje e profesionalizmi duke marrë vlerësimet më të larta nga partnerët tanë ndërkombëtar.

Suksese të mëtejshme në rrugëtimin tuaj në realizimin me sukses të çdo misioni që do t'ju ngarkohet në të ardhmen."

Gëzuar dhe ju uroj shëndet dhe

mbarësi për ju dhe familjet tuaja!

Komandanti i Njësisë Speciale Ajet Jata në fjalën e tij përshëndetëse do ishte falenderues për realizimin e detyrave nga ana e Forcave Speciale si dhe mirënjohjen për përkrahjen në këtë rrugëtim të vështirë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe Komandantit të Forcës Tokësore.

I nderuar Zoti Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Prof. Asoc. Bajram Begaj;

I nderuar Zoti Komandant i Forcës Tokësore Gjeneral Brigade Kingji,

Komandant i ROS, Kol. Zani,

Të nderuar, ish komandantë, të ftuar dhe pjesëtarë të Forcave Speciale.

dhi vetëm si nevojë e domosdoshme e një asemi kombëtar të munguar, por edhe e punës, përkushtimit dhe vullnetit të jashtëzakonshëm të të gjithë pjestarëve të parë me në krye N/Kol Hysen Ymeri i cili arriti të hedhë bazat e krijimit të Forcave Speciale dhe të formësorë këtë njësi, ku stërvitja dhe profesionalizmi ishin tipari kryesor dallues nga pjesa tjetër e ushtrisë.

Përgjatë këtij rrugëtimi 23 vjeçar sfidues por edhe frytëdhënës, kanë ndodhur transformime të mëdha në kuadrin e formimit operacional të FS si modernizimi në paisje, përshtatja në koncepte, pjesëmarrje në operacione të shumta speciale, përshtatja e taktikave dhe teknikave të reja, teknika të fituar

më e ndërveprueshme, kjo falë punës së palodhur të çdo pjestari ndër vite të FS por edhe e mbështetjes së pakursyer nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Komanda e FT dhe së fundmi ROS.

Të nderuar pjesëmarrës!

Rrugëtimi i FS nuk do ndaloj sot, përkundrazi, na presin sfida akoma më të mëdha, ne duhet të ecim përkrah FS të NATO-s dhe si të tilla duhet të përmbushim angazhimet e marra duke krijuar një Task Grup Tokësor të FS të gatshme për t'u dislokuar në kuadër të NATO-s, por edhe vijimin e punës për krijimin e kapaciteteve tona kombëtare përtej angazhimeve ndaj aleancës, ku synojmë që Forcat Speciale të jenë të afta të kryejnë detyra në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake, në mëvetësi apo me forcat konvencionale.

Si komandant i kësaj njësie, me bindje të plotë ju them se Forcat Speciale nuk janë vetëm imazhi i forcës, kapaciteteve dhe aftësive speciale, por janë edhe një aset kombëtar, janë zgjidhje dhe jo zgjedhje, njësi shumë e vlefshme që zotërojnë aftësi dhe eksperiencë operacionale, e nëse përdoren në mënyrën e duhur ato sjellin benefite të mëdha për vendin dhe kombin dhe nëse përdoren jo në mënyrën e duhur ka humbje të aftësive dhe të eksperiencës së tyre. Ndaj me plot siguri them: "Nëse mjekët janë diagnostifikuesit më të mirë të sëmundjeve në shëndetin e njeriut, FS janë diagnostifikuesit më të mirë të sigurisë në ditët e sotme" (Ajet Jata)"

Zoti Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Zoti Komandant i Forcës Tokësore!

Më lejoni t'ju shpreh në emër të të gjithë efektivit të FS mirënjohjen time të thellë për praninë tuaj sot këtu dhe për mbështetjen e pakursyer të dhënë nga ana JUAJ për Batalionin Special.

Duke shfrytëzuar këtë ditë feste, unë ju siguroj se do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim e profesionalizëm duke garantuar përmushjen e misionit dhe të detyrave si dhe duke lartësuar emrin e batalionit të forcave speciale.

Për efektivin e batalionit të Forcave Speciale, Gëzuar 23 vjetorin e krijimit, shëndet, suksese dhe çdo të mirë në familje, punë dhe kudo.

Punoi:

Anjeza Musollari



Shumë faleminderit për praninë tuaj në këtë ditë të shënuar për Batalionin e Forcave Speciale. 23 vite më parë me vendimin e veçantë të Kryetarit të Këshillit Mbrojtjes (Zotit Rexhep Meidani) Nr 02 Datë 16.10. 1998 u krijuan për herë të parë Forcat Speciale Shqiptare.

Vendimarrja për krijimin e Forcave Speciale lidhet me situatën në veri të vendit si rezultat i luftës që zhvillohej në Kosovë, me nevojën e pasjes së një force elitare dhe të aftë për të kryer detyra speciale me spektër të plotë.

Po ashtu lidhet me reflektimin ndaj një koncepti operacional të munguar në hierarkinë e forcave luftuese, ku Forcat Speciale janë njësi dhe instrumenti më fleksibël dhe më i dobishëm i sigurisë kombëtare, ku nëpërmjet detyrave taktike japin impakte strategjike.

Krijimi i Forcave Speciale nuk er-

së fundmi nga eksperiencia nëpër misione dhe trajnimi me Forcat Speciale të ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s, si dhe krijimin e një koncepti të qartë për të ardhmen, na bëjnë të ndihemi krenar për të gjitha arritjet e kësaj njësie. Në këtë rrugëtim pa kthim, kjo njësi ka treguar integritet, disiplinë, kurajo, vetmohim dhe trimëri në përmbushje të misionit dhe të detyrave të ngarkuara brenda dhe jashtë vendit duke i dhënë vendit tonë dëshmorin e parë të atdheut nga radhët e batalionit të forcave speciale Kapiten Feti Voglin, ku sakrifica, devotshmëria dhe vetmohimi i tij në përmushje të misionit dhe detyrave të ngarkuara është një shembull i skalitur në mendjet dhe zemrat e çdo pjestari të FS

Sot pas më shumë se dy dekadave, kjo njësi është më e konsoliduar, me më shumë eksperiencë dhe



VIZITA NË UASHINGTON

Mehaj: Aty ku ka nevojë Amerika, aty do të jetë edhe ushtria e Kosovës krah për krah me ta

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, teksa ka pranuar Raportin e Progresit – të përpiluar nga Komisioni Evropian – për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, në një takim që ka pasur me shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë Tomas Szunyog, ka thënë se shteti që ajo udhëheq, e ka prioritet anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe se askush nuk mund të ndalë vendosmërinë e institucioneve të Kosovës për sundim të ligjit dhe për të mbrojtur integritetin e institucioneve.

Ajo e ka mirëpritur rikonfirmimin e mbështetjes së Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, dhe ka thënë se liberalizimi është proces qenësor për ruajtjen e kredibilitetit të BE-së në raport me zbatimin e politikës së zgjerimit.

Raportin e ka pranuar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Kryeministri Kurti ka konsideruar se në gjashtëmujorin e dytë, Kosova ka shënuar shumë përparim, periudhë kur ka nisur udhëheqjen Qeveria e tij.

“Në këta gjashtë muaj të Qeverisë, kemi stabilitet institucional, legjitimitet demokratik dhe besueshmëri të lartë në institucione nga ana e qytetarëve, që përbën progres të madh shoqëror, që do ta kishin zili, jo vetëm e rajonit, por edhe jo pak vende të Bashkimit Evropian”, është mësuar të jetë shprehur Kurti. Ky raport përfshin gjetjet për të gjitha vendet që synojnë



të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Në raportin e këtij viti është parë përparim i kufizuar i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë drejt përmbushjes së kriterëve për integrim në Bashkimin Evropian.

Dokumenti është prezantuar nga Komisioneri evropian për Zgjerimin, Oliver Varhelyi.

Gjatë prezantimit, Komisioneri Varhelyi ka thënë se politika e BE-së për zgjerimin është interes strategjik i bllokut evropian për paqen, stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.

Raportet janë hartuar për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Bosnje- Hercegovinë, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë) si dhe Turqinë. Në raportin e këtij viti është thënë se Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje të tjera substanciale në “zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të kaluara” të arritura në kuadër të dialogut me Serbinë dhe të “kontribuojë në arritjen e një mar-

rëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë”. Sipas raportit, jostabiliteti politik dhe pandemia kanë ndikuar në përparim të kufizuar sa i përket axhendës së reformave evropiane të Kosovës.

Aty është përmendur edhe jostabiliteti politik në Kosovë, më konkretisht “atmosfera polarizuese politike”.

Komisioni Evropian, megjithatë ka thënë se Kosova ka bërë përparim në luftën kundër terrorizmit, “veçanërisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre”.

Megjithatë, Komisioni Evropian ka pasur kritika për sistemin gjyqësor, pasi sipas tij, administrimi i drejtësisë vlerësohet se vazhdon të jetë “i ngadalshëm, joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndikimeve politike”. Si pikë pozitive është parë Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit, që është miratuar në gusht të vitit 2021.



Politika e BE-së për zgjerimin është interes strategjik i bllokut evropian për paqen

Presidentja Osmani: Prioriteti i Kosovës anëtarësimi në BE

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, teksa ka pranuar Raportin e Progresit – të përpiluar nga Komisioni Evropian – për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, në një takim që ka pasur me shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë Tomas Szunyog, ka thënë se shteti që ajo udhëheq, e ka prioritet anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe se askush nuk mund të ndalë vendosmërinë e institucioneve të Kosovës për sundim të ligjit dhe për të mbrojtur integritetin e institucioneve.

Ajo e ka mirëpritur rikonfirmimin e mbështetjes së Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, dhe ka thënë se liberalizimi është proces qenësor për ruajtjen e kredibilitetit të BE-së në raport me zbatimin e politikës së zgjerimit. Raportin e ka pranuar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Kryeministri Kurti ka konsideruar se në gjashtëmuorin e dytë, Kosova ka shënuar shumë përparim, periudhë kur ka nisur udhëheqjen Qeveria e tij.

“Në këta gjashtë muaj të Qeverisë, kemi stabilitet institucional, legjitimitet demokratik dhe besueshmëri të lartë në institucione nga ana

e qytetarëve, që përbën progres të madh shoqëror, që do ta kishin zili, jo vetëm e rajonit, por edhe jo pak vende të Bashkimit Evropian”, është mësuar të jetë shprehur Kurti. Ky raport përfshin gjetjet për të gjitha vendet që synojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Në raportin e këtij viti është parë përparim i kufizuar i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë drejt përmbushjes së kriterëve për integrim në Bashkimin Evropian.

Dokumenti është prezantuar nga Komisioneri evropian për Zgjerimin, Oliver Varhelyi.

Gjatë prezantimit, Komisioneri Varhelyi ka thënë se politika e BE-së për zgjerimin është interes strategjik i bllokut evropian për paqen, stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.

Raportet janë hartuar për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Bosnje- Hercegovinë, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë) si dhe Turqinë. Në raportin e këtij viti është thënë se Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje të tjera substanciale në “zbatimin e të gjitha marrëveshjeve

të kaluara” të arritura në kuadër të dialogut me Serbinë dhe të “kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë”. Sipas raportit, jostabiliteti politik dhe pandemia kanë ndikuar në përparim të kufizuar sa i përket axhendës së reformave evropiane të Kosovës.

Aty është përmendur edhe jostabiliteti politik në Kosovë, më konkretisht “atmosfera polarizuese politike”.

Komisioni Evropian, megjithatë ka thënë se Kosova ka bërë përparim në luftën kundër terrorizmit, “veçanërisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre”.

Megjithatë, Komisioni Evropian ka pasur kritika për sistemin gjyqësor, pasi sipas tij, administrimi i drejtësisë vlerësohet se vazhdon të jetë “i ngadalshëm, joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndikimeve politike”. Si pikë pozitive është parë Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit, që është miratuar në gusht të vitit 2021.



“Java për të Drejtat e Viktimave të Krimin”

Osmani: Statistikat e viktimave të krimit janë trishtuese, kriminelët të ndëshkohen

“Java për të Drejtat e Viktimave të Krimin”, me moton “Së bashku në mbrojtje të viktimave të krimit”. Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi tha se Republika e Kosovës tashmë është prijëse në rajon sa i përket legjislacionit dhe trajtimit të viktimave të krimit sipas praktikave dhe standardeve më të avancuara ndërkombëtare.

Lumezi tha se viktimat e krimit ngadalë por sigurt po i realizojnë të drejtat e tyre dhe po e marrin trajtimin e duhur nga institucionet vendore.

Ndërsa, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani tha se statistikat e viktimave të krimit janë trishtuese, prandaj kërkoi përkushtim dhe ndëshkim për të gjithë kryesit e krimeve.

Ndërsa ka ofruar mbështetjen e saj në mbrojtje të viktimave të krimit, Osmani kërkoi nga përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë që të punojnë me integritet dhe profesionalizëm me qëllim që të rritet besimi i qytetarëve karshi institucioneve të drejtësisë. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu krahas thirrjes për ndëshkueshmëri sa më të lartë ndaj atyre mbi të cilët rëndojnë akte kriminale, tha se mbrojtja e viktimave të krimit është prioritet i tyre. “Viktimë e krimit mund të jetë kushdo por shqetësuese janë rastet e shumta të dhunës në familje dhe ndaj fëmijëve, prandaj prioriteti ynë është trajtimi i dhunës në familje përmes ndryshimeve të shumë ligjeve”, -tha ajo.



FSK vazhdon me stërvitje dhe gara ushtarake bashkë me vendet anëtare dhe partnere të NATO-s

Një kontingjent i FSK-së mori pjesë në Stërvitjen Qendrore të Forcave të Armatosura Sllovene për vitin 2021, “Disaster Relief and Military Mobility Exercise 2021” (DRM2 EX21), duke iu bashkangjitur kështu kolegëve të tyre të forcave sllovene dhe 19 forcave të shteteve tjera të BE-së dhe NATO-s. Kjo stërvitje synon të forcojë gatishmërinë e Forcave të Armatosura sllovene në sistemin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Republikën e Sllovenisë. Gjithashtu, kjo stërvitje synon për të integruar edhe mekanizmat e sigurisë sllovene me shtetet anëtare të BE-së dhe forcat tjera partnere, si vendi ynë, të rëndësishme në fushën e modernizimit ushtarak dhe mbështetjes logjistike.

Në po të njëjtën kohë, një njësi tjetër e FSK-së, me ftesë të ushtrisë sllovene, merr pjesë në Garën Ushtarake Ndërkombëtare “Skuadra më e mirë 2021”. Në këtë garë konfirmohen shkathtësitë e pjesëtarëve të FSK-së dhe promovohet bashkëpunimi ndërkombëtar i korpunit të nënoficerëve tanë në ndërveprim me kolegët sllovenë dhe kolegët tjerë nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s.

Ministri Mehaj dhe gjeneral Rama vizitë dhe takime të suksesshme në SHBA

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj i shoqëruar me Komandantin e FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit, kanë marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së Ekspozitës Vjetore të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (The Association of the United States Army) – “AUSA 2021”. Ministri Mehaj dhe gjeneral Rama, të cilët janë të ftuar zyrtarisht nga presidenti i AUSA-së, gjeneral Carter F. Ham, patën mundësinë të njihen me produktet e ekspozitës ushtarake dhe shumë prezantime të tjera të zhvillimit profesional, të ofruara nga liderë ushtarakë të Ushtrisë Amerikane dhe të Departamentin Amerikan të Mbrojtjes. Në po të njëjtën ditë, ministri Mehaj dhe gjeneral Rama nderuan dhe përkujtuan me respektin më të lartë, të gjithë ushtarakët amerikanë –dëshmorë të lirisë dhe paqes kudo në botë. Pas nderimit me kurorë lulesh pranë Varrit të Ushtarit të Panjohur në Varrezat Kombëtare në Arlington, ata vizituan edhe Muzeun e Kompleksit Memorial, ku ministri Mehaj dhuroi një replikë të helmetës iliro-dardane. Kjo helmetë u vendos në vend të rëndësishëm të Muzeut, si simbol i mirënjohjes, nderit dhe respektit të përjetshëm të kombit tonë për SHBA-në, kombin amerikan dhe ushtarët e saj. Në po të njëjtën ditë, ministri Mehaj së bashku me gjeneral Ramën, takuan Drejtoreshën e Agjencisë së Bashkëpunimit të Sigurisë së Mbrojtjes të Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-së, znj. Heidi Grant. Me znj. Grant ata vazhduan diskutimet e nisura nga takimi i fundit në Split, lidhur me format e thellimit të bashkëpunimit dhe zbatimit sa më të suksesshëm dhe efektiv të konceptit të blerjeve ushtarake, përmes Programit të Shitjeve të Jashtme Ushtarake të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-së. Ministri Mehaj dhe znj. Grant u pajtuan se bashkëpunimi



midis SHBA-së dhe Republikës së Kosovës udhëhiqet nga vlera dhe interesa të përbashkëta, andaj theksuan se do të intensifikojnë edhe më shumë angazhimet në mënyrë që të përmbushen qëllimet e përbashkëta të mbrojtjes. Gjatë ditës së dytë të ekspozitës “AUSA 2021”, ministri Mehaj takoi edhe gjeneralin ameri-

kan në pension Randal Dragon, drejtor i Kompanisë Këshilluese të Agjencitë Federale Civile dhe të Mbrojtjes (LMI). Me gjeneral Dragon ata diskutuan, përveç tjerash, edhe për prokurimin dhe blerjet ushtarake si dhe shkëmbyen eksperiencat e ndërsjella lidhur me këto çështje.

Bashkëpunimi ushtarak Kosovë-Maqedoni e Veriut, me rëndësi shumë të madhe për sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë

Me nderime të larta ushtarake, në Ministrinë e Mbrojtjes u prit shefi i shtabit të përgjithshëm të forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjeneralletenant Vasko Gjurchinovski. Në fillim, atij i dëshiroi mirëseardhje komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama dhe më pas u prit në takim nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Me këtë rast, ministri Mehaj vlerësoi lartë rolin dhe kontributin e Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut në kuadër të KFOR-it dhe misionet tjera në kuadër të NATO-s. Gjithashtu, ai vlerësoi bashkëpunimin e deritashëm ushtarak mes dy forcave, me besimin se do të thellohet edhe më tej edhe në të ardhmen. Pas takimit me ministrin Mehaj, gjeneralletenant Gjurchinovski u prit në zyrën e komandantit të FSK-së, gjeneral Ramës, ku pas takimit kokë më kokë ata diskutuan edhe nivel të dy delegacioneve. Gjatë këtyre takimeve u vlerësua lart bashkëpunimi ushtarak ndërmjet forcave të të dy vendeve duke diskutuar për konkretizimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të planit të bashkëpunimit bilateral. Me theks të veçantë u diskutua nevoja për intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe stërvitjes të dy forcave. Më pas, gjeneral Gjurchinovski dhe delegacioni i tij vizituan kazermin e FSK-së në Pomozatin, respektivisht Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit në kërkim-shpëtim. Kjo vizitë u realizua në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit në mes ministrive të mbrojtjes së dy vendeve.

Ministrat e mbrojtjes të 30 vendeve anëtare të Aleancës, gjatë takimeve dyditore të Këshillit të Atlantikut të Veriut, miratuan objektivat e aftësive për Maqedoninë e Veriut, për herë të parë pas anëtarësimit të RMV-së në Aleancë.

Siç njoftojnë nga Ministria e Mbrojtjes, objektivat e aftësive tregojnë drejtimin në të cilin do të zhvillohen forcat dhe kapacitetet e armatave të NATO-s. Ata janë pjesë e procesit të planifikuar të Aleancës dhe vendeve anëtare dhe detyra e tyre bazë është që ta përforcojnë mbrojtjen kolektive të NATO-s. "Ky proces mundëson që vendet anëtare të mbështeten dhe të ndihmohen në përballjen me sfidat e ardhshme, veçanërisht duke pasur parasysh se çdo vend zhvillon kapacitete specifike, të cilat së bashku e bëjnë Aleancën më të fuqishme dhe më të gatshme për ta garantuar sigurinë dhe stabilitetin në fushën euroatlantike", theksojnë nga ministria.

Ministrat e Mbrojtjes në takime biseduan edhe për Afganistanin dhe nevojën që të mos lejohet më kurrë që ky vend të jetë bastion i terrorizmit. Në një operacion kompleks, por të mirë-koordinuar të NATO-s, më shumë se 130,000 njerëz janë evakuuar nga Afganistani, të cilët kanë ndihmuar forcat e NATO-s në vend për dy dekadat e fundit. Maqedonia Veriore, shtoi Ministria, dhe në këtë rast, me pranimin e përkohshëm të një numri qytetarësh afganë, ka treguar se është një aleat në të cilin Aleanca mund të mbështetet. Në vazhden e këtyre takimeve, ministrja Radmilla Shekerinska realizoi shumë takime me ministrat e vendeve aleate në të cilat është konfirmuar angazhimi për zhvillimin e marrëdhënieve reciproke bilaterale mbrojtëse. Shekerinska në Bruksel, u takua edhe me sekretarin e përgjithshëm të Shërbimit evropian për veprim të jashtëm, Stefano Sanino ku përcolli mesazhin se Maqedonia e Veriut ka treguar rezultate dhe se është e nevojshme që Unioni sa më shpejt të jetë e mundur ta hapë rrugën drejt anëtarësimit të plotfuqishëm.

MAQEDONIA E VERIUT

Ministrja Radmilla Shekerinska: E nevojshme që Unioni të hapë rrugën drejt anëtarësimit sa më shpejt të jetë e mundur



Në selinë e Aleancës së NATO-s në Bruksel, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska hapi më 20 tetor ekspozitën me titull "Rruga e Maqedonisë së Veriut drejt NATO -s".

"Kam kënaqësinë të hap këtë ekspozitë e cila përfaqëson rrugën tonë drejt Aleancës. Momenti i anëtarësimit në NATO ishte një moment për t'u mbajtur mend, një moment krenarie. "Ne patëm sukses sepse ishim të përkushtuar dhe sepse kishim mbështetjen tuaj," tha ministrja në hapje para ambasadorëve të NATO -s.

Shekerinska falënderoi përfaqësuesit e shteteve anëtare për të gjithë ndihmën ndër vite drejt anëtarësimit të plotë dhe tha se Maqedonia e Veriut e vlerëson dhe nuk e harron këtë.

Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës për Diplomacinë Publike Baiba Brazhe theksoi se ekspozita ilustron një rrugë të mbushur me angazhim dhe mençuri. "Ju jeni një

Maqedonia e Veriut-pjesë e grupit luftarak të Aleancës në Letoni

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska bashkë me ministrat e mbrojtjes të vendeve aleate merr pjesë në takimet e Këshillit Euroatlantik.

Temat kyçe që u trajtuan në takimet e Këshillit Euroatlantik janë ato që ngjallin gjithmonë interes, dhe ato janë sfidat gjeopolitike të Aleancës, bashkëpunimi me BE-në por edhe të gjithë partnerët që ndajnë të njëjtat vlera dhe nënkuptohet kryesisht – politika e parandalimit të NATO-s që nënkupton kohezion më të madh, prani më të madhe të NATO-s dhe politikat e duhura që ne duhet ti formulojmë në prag të samitit të Madridit”, tha ministrja Shekerinska para fillimit të takimeve.

Ministrja Shekerinska shtoi se ministrat e mbrojtjes do të vazhdojnë të punojnë për dokumentin NATO 2030 dhe avancimin e strukturës së NATO-s dhe do të hapet diskutim për mësimet që Aleanca mund të nxjerrë nga përvoja në Afganistan.

Përpara sesionit të parë të Këshillit të Atlantikut të Veriut, Ministrja Shekerinska u takua me ministren e Mbrojtjes të Spanjës, Margarita Robles, duke riafirmuar angazhimin e dy vendeve për bash-

Ministrja Shekerinska: Ministrat e mbrojtjes do të vazhdojnë të punojnë për dokumentin NATO 2030 dhe avancimin e strukturës së NATO-s dhe do të hapet diskutim për mësimet që Aleanca mund të nxjerrë nga përvoja në Afganistan



këpunim më intensiv të mbrojtjes, veçanërisht në fushën e trajnimit dhe edukimit, stërvitjeve ushtarake, përbaljes me kërcënime hibride dhe dezinformata.

Në margjinat e Këshillit të

Atlantikut të Veriut, ministrja u takua me ministrin e Mbrojtjes së Kroacisë, Mario Banozhiq, ku u diskutua për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, si dhe për sfidat me të cilat ballafaqohet Ballkani.

“RRUGA E MAQEDONISË SË VERIUT DREJT NATO -S”

Ministrja Shekerinska: Ne ia dolëm sepse ishim të përkushtuar dhe patëm mbështetjen tuaj

histori sukcesi,” tha Brazhe. Në ekspozitë janë paraqitur 28 fotografi të njerëzve dhe ngjarjeve që shënuan rrugën e vendit tonë drejt NATO-s, në periudhën nga viti 1993 deri në vitin 2021. Pas ekspozitës, në ambientet e Delegationit të Përhershëm të Maqedonisë së Veriut në Aleancë, ministrja Shekerinska falënderoi shumë njerëz që brenda NATO-s mbështetën dhe ndihmuan fuqishëm integrimin e vendit tonë në Aleancë ndër vite.



Siguria në rajonin e Detit Baltik

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Me ftesë të autoriteteve finlandeze dhe suedeze, Këshilli i Atlantikut të Veriut vizitoi Finlandën dhe Suedinë nga 25 deri më 27 tetor 2021.

Vizita filloi në Helsinki më 25 tetor, ku Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me Presidentin e Republikës së Finlandës, z. Sauli Niinistö, e më pas u vijua me një angazhim të anëtarëve të Këshillit të Atlantikut të Veriut me Presidentin. Sekretari i Përgjithshëm dhe anëtarët e Këshillit të Atlantikut të Veriut u takuan me zyrtarë të lartë politikë dhe ushtarakë në Finlandë, si dhe me përfaqësues të lartë parlamentarë finlandezë.

Më 26 tetor, në Helsinki, anëtarët e Këshillit të Atlantikut të Veriut, vazhduan takimet me drejtues të lartë qeveritarë dhe u informuan nga Qendra Evropiane e Ekselencës Kundër Kërcënimeve Hibride (Hybrid CoE). Këshilli i Atlantikut të Veriut udhëtoi drejt Stokholmit të njëjtën ditë, më 26 tetor 2021, ku Sekretari i Përgjithshëm u prit nga Lartmadhëria e Tij, Mbreti Carl XVI Gustaf dhe zhvilloi një takim dypalësh me Kryeministrin e Mbretërisë së Suedisë, Stefan Lofven. Anëtarët e Këshillit të Atlantikut të Veriut gjithashtu u takuan me Kryetarin e Parlamentit dhe përfaqësues të lartë të Parlamentit suedez dhe morën pjesë në seminarin me temë "Sfidat e sigurisë në rajonin e Detit Baltik". Më 27 tetor, Këshilli i Atlantikut të Veriut, së bashku me ministrin e Mbrojtjes të Suedisë dhe ministrin e Mbrojtjes të Finlandës



vizituan bazën detare Berga dhe ndoqën stërvitjen e përbashkët detare suedeze/finlandeze Swenex. NATO ka thelluar bashkëpunimin e saj me Suedinë dhe Finlandën vitet e fundit. Në Samitin e NATO-s në qershor, aleatët përshëndetën bashkëpunimin e ngushtë të sigurisë së NATO-s me Finlandën dhe Suedinë, vende të cilat ndajnë vlerat e përbashkëta dhe kontribuojnë në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO. Udhëheqësit aleatë u zotuan gjithashtu për të forcuar dialogun politik dhe bashkëpunimin midis NATO-s, Suedisë dhe Finlandës, në mbështetje të sigurisë së përbashkët, përfshirë përgatitjen për menaxhimin e krizave, stërvitjet dhe shkëmbimin e informacionit dhe analizave, duke përfshirë rajonin e Detit Baltik.

Stoltenberg nga vizita në Finlandë: Së bashku e bëjmë rajonin më të qëndrueshëm

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dhe ambasadorët e Këshillit të Atlantikut të Veriut u takuan me Presidentin finlandez Sauli Niinistö në Helsinki,

më 25 tetor 2021, në fillim të vizitës tre-ditore në Finlandë dhe Suedi. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet NATO-s dhe Finlandës për sigurinë në rajonin e Detit Baltik, si dhe në Veriun e Lartë. Duke iu drejtuar mediave pas takimit të tij me Presidentin Sauli Niinistö, Stoltenberg tha se "së bashku, ne e bëjmë rajonin euro-atlantik më të sigurt dhe më të qëndrueshëm, duke përfshirë praninë e zgjeruar të NATO-s në rajonin e Baltikut, misionin tonë të policisë ajrore dhe sigurisht angazhimin e Finlandës për mbrojtjen e saj kombëtare", -tha ai. Stoltenberg vlerësoi Finlandën për kontributin e saj në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, nga Ballkani Perëndimor në Irak. Sekretari i Përgjithshëm dhe Presidenti Niinistö diskutuan gjithashtu politikën e dyerve të hapura të NATO-s dhe Sekretari i Përgjithshëm theksoi se dera e Aleancës mbetet e hapur për vendet në Evropë që plotësojnë kriteret për anëtarësim.

Në Helsinki, Sekretari i Përgjith-

shëm u takua edhe me Kryeministren Sanna Marin dhe ministren e Jashtme Pekka Haavisto për bisedime mbi forcimin e partneritetit të NATO-s me Finlandën. Ai vizitoi gjithashtu Regjimentin e Gardës Jaeger së bashku me ministrin e Mbrojtjes Antii Kaikkonen dhe komandantin e Forcave të Mbrojtjes Finlandeze, gjeneralin Timo Kivinen.

Bashkëpunimi finlandez me NATO-n bazohet në politikën e saj të mos angazhimit ushtarak dhe një konsensus të fortë politik kombëtar.

Bashkëpunimi filloi kur Finlanda iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në 1994 dhe Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (një forum shumëpalësh për dialogun që bashkon të gjithë aleatët dhe vendet partnere në zonën euro-atlantike) në 1997. Programi Individual i Partneritetit dhe Bashkëpunimit (IPCP), i cili është vendosur bashkërisht për një periudhë dyvjeçare, parashton programin e bashkëpunimit midis Finlandës dhe NATO-s. Finlanda është një nga partnerët më aktivë të NATO-s dhe ka qenë një kontribuues i çmuar në operacionet dhe misionet e NATO-s në Ballkan, Afganistan dhe Irak. Finlanda është një nga gjashtë vendet (të njohura si 'Partnerët e Mundësive të Përmirësuar' sipas Iniciativës së Ndërveprueshmërisë së Partneritetit) që japin kontribute veçanërisht të rëndësishme në operacionet e NATO-s dhe objektivat e tjera të Aleancës. Si i tillë, ky vend ka shtuar mundësitë për dialog dhe bashkëpunim me aleatët.

Në kontekstin aktual të sigurisë së shqetësimeve të shtuara për aktivitetet ushtarake dhe jo ushtarake ruse, NATO ka rritur bashkëpunimin me vendet partnere Finlandën dhe Suedinë, me një fokus të veçantë në garantimin e sigurisë në rajonin e Detit Baltik. Kjo përfshin dialogun dhe konsultimet e rregullta politike; shkëmbimi i informacionit mbi luftën hibride; koordinimin e trajnimeve dhe ushtrimeve; dhe zhvillimin e ndërgjegjësimit më të mirë të situatës së përbashkët për të adresuar kërcënimet e përbashkëta dhe për të zhvilluar veprime të përbashkëta, nëse është e nevojshme. Të dy partnerët marrin pjesë në Forcën e zgjeruar të Reagimit të NATO-s (NRF) në një rol plotësues dhe subjekt i vendimeve

kombëtare. Për më tepër, të dy partnerët kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për Mbështetjen e Vendit Pritës, i cili, në varësi të një vendimi kombëtar, lejon mbështetjen logjistike për forcat aleate të vendosura në territorin e tyre ose në transit përmes tyre gjatë stërvitjeve ose në një krizë.

Nga vizita në Suedi: Sekretari i Përgjithshëm thekson fuqinë e partneritetit të NATO-s me Suedinë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg theksoi vlerën e partneritetit të Aleancës me Suedinë gjatë vizitës me ambasadorët e Këshillit të Atlantikut të Veriut, në Stokholm, më 26 tetor 2021. Sekretari i Përgjithshëm u takua me Madhërinë e Tij, Mbretin e Suedisë, Carl XVI Gustaf, dhe zhvilloi bisedime me Kryeministrin Stefan Löfven. Ai vlerësoi kontributin e Suedisë në misionet dhe operacionet e NATO-s, nga Ballkani Perëndimor në Irak. Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeministri diskutuan përparimin në forcimin e bashkëpunimit midis NATO-s dhe Suedisë, duke përfshirë shkëmbimet e shtuar të informacionit, stërvitjet e përbashkëta dhe dialogun politik. "Unë vlerësoj partneritetin shumë të fortë që kemi zhvilluar midis Suedisë dhe NATO-s gjatë disa viteve, dhe mënyrën se si ne punojmë së bashku në adresimin e sfidave të përbashkëta. Ne ndajmë të njëjtat vlera, ndajmë të njëjtën fqinjësi dhe jetojmë në një botë më komplekse dhe më të paparashikueshme, dhe atëherë është e rëndësishme që të kemi partneritet midis tridhjetë aleatëve të NATO-s dhe Suedisë", -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg. "Faleminderit shumë që më pritët mua dhe delegacionin tim. Kjo është një vizitë historike sepse është hera e parë që i gjithë Këshilli i Atlantikut të Veriut, që përfaqëson tridhjetë aleatët, viziton Stokholmin dhe takohet me ju dhe institucionet qeveritare të Suedisë", -tha ai. Sekretari i Përgjithshëm u takua edhe me ministren e Jashtme Ann Linde, ministrin e Mbrojtjes Peter Hultqvist dhe ministrin e Punëve të Brendshme Mikael Damberg dhe vizitoi HMS Carlskrona, anija më e madhe në Marinën Suedeze. NATO respekton plotësisht politikën e gjatë të

Suedisë për mos-angazhim ushtarak. Bashkëpunimi filloi kur Suedia iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në 1994 dhe Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (një forum shumëpalësh për dialogun që bashkon të gjithë aleatët dhe vendet partnere në zonën euro-atlantike) në 1997.

NATO dhe Suedia detajojnë fushat e bashkëpunimit dhe afatet kohore në Programin e Bashkëpunimit të Partneritetit Individual të Suedisë (IPCP), i cili është vendosur bashkërisht për një periudhë dyvjeçare. Suedia është një nga partnerët më aktivë të NATO-s dhe ka qenë një kontribuues i çmuar në Misionin e Mbështetjes Vendimtare të udhëhequr nga NATO në Afganistan, Forcën e Kosovës (KFOR) në Kosovë dhe Misionin e NATO-s në Irak (NMI). Suedia është një nga gjashtë vendet (të njohura si 'Partnerët e Mundësive të Përmirësuar' nën Iniciativën e Ndërveprueshmërisë së Partneritetit) që japin kontribute veçanërisht të rëndësishme në operacionet e NATO-s dhe objektivat e tjera të Aleancës. Si i tillë, ky vend ka shtuar mundësitë për dialog dhe bashkëpunim me aleatët.

Në kontekstin aktual të sigurisë së shqetësimeve të shtuara në lidhje me aktivitetet ushtarake dhe jo ushtarake ruse, NATO po rrit bashkëpunimin me vendet partnere Suedinë dhe Finlandën, me një fokus të veçantë në garantimin e sigurisë në rajonin e Detit Baltik. Kjo përfshin: dialogun dhe konsultimet e rregullta politike; shkëmbimi i informacionit mbi luftën hibride; koordinimi i trajnimeve dhe ushtrimeve; dhe zhvillimi i ndërgjegjësimit më të mirë të situatës së përbashkët për të adresuar kërcënimet e përbashkëta dhe për të zhvilluar veprime të përbashkëta, nëse është e nevojshme. Të dy partnerët marrin pjesë në Forcën e zgjeruar të Reagimit të NATO-s (NRF) në një rol plotësues dhe subjekt i vendimeve kombëtare. Për më tepër, të dy partnerët kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për Mbështetjen e Vendit Pritës, i cili, në varësi të një vendimi kombëtar, lejon mbështetjen logjistike për forcat aleate të vendosura në territorin e tyre ose në tranzit përmes tyre gjatë stërvitjeve ose në një krizë.

Forumi To Be Safe (2BS)

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Bashkëpunimi i ngushtë do të na mbajë të sigurt

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Në Forumin virtual To Be Safe (2BS) të organizuar nga Këshilli Atlantik i Malit të Zi, (15 tetor 2021), Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană, vlerësoi kontributet e vlefshme që Mali i Zi po jep për Aleancën, por dhe për sigurinë dhe stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Paqja dhe stabiliteti i qëndrueshëm në këtë rajon kërkojnë përpjekjen tonë të vazhdueshme kolektive”, tha z. Geoană, “politikat tona në rajon, përfshirë politikën tonë të Dyerve të Hapura, ndihmojnë në forcimin e stabilitetit dhe ndërtimin e bashkëpunimit më të madh në Ballkanin Perëndimor”.

Duke reflektuar mbi sfidat e sigurisë së sotme dhe të nesërme, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e partneriteteve globale dhe bashkëpunimin e ngushtë me partnerët me mendje të njëjtë. “Sa më shumë të bashkëpunojmë, aq më shumë shans kemi për të mbrojtur stilin tonë demokratik të jetesës kundër atyre që përpiqen të na dëmtojnë”, tha ai.

Vendimet e Samitit të Brukselit të NATO-s dhe agjenda e vitit 2030 përcaktuan një agjendë ambicioze për të siguruar që Aleanca është e përgatitur për t’u përballur me këto sfida, shtoi ai. Duke pritur Samitin e Madridit të vitit 2022, aleatët variojnë nga forcimi i qëndrimit pen-gues dhe mbrojtës, deri te rritja e



elasticitetit kombëtar dhe kolektiv dhe investimi më shumë në teknologji inovative.

Stabiliteti në BP kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe vëmendje të përhershme

Në fjalën e tij Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană, në forumin To Be Secure (2BS), duke falenderuar Malin e Zi për organizimin e takimit To Be Safe (2BS) si “një ngjarje e madhe”, siç tha ai, uroi Malin e Zi “për festimin e 15 vjetëve të punës së përkushtuar në forcimin e demokracisë, sigurisë dhe stabilitetit në vend dhe rajonin më gjerë”. Mircea Geoană tha ndërkohë se puna e Malit të Zi është e çmuar dhe sidomos po aq të çmuara janë diskutimet që “zhvillohen në këtë Forum” edhe pse virtualisht. “Këtë vit në qershor, ne shënuam përvjetorin e katërt të anëtarësimit të Malit të Zi në NATO dhe ne ishim të nderuar të kishim

Presidentin dhe Kryeministrin në Shtabin e NATO-s në muajt e fundit. Vendi juaj është një aleat i çmuar, duke dhënë kontribute të rëndësishme për sigurinë euroatlantike. Trupat malazezë ishin në Afganistan për më shumë se një dekadë. Ato janë të angazhuar në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë. Unë mirëpres që Mali i Zi po rrit shpenzimet e tij të mbrojtjes”, tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s Mircea Geoana. “Këto kontribute na bëjnë të gjithëve më të fortë dhe më të sigurt dhe ato ndihmojnë në ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, një rajon që është me rëndësi strategjike për NATO-n.”, theksoi ai. “Paqja dhe stabiliteti i qëndrueshëm në këtë rajon kërkojnë përpjekjen tonë të vazhdueshme kolektive dhe vëmendjen e përhershme. Të gjitha vendet individuale mund të luajnë një rol për të ruajtur demokracinë dhe sundimin

e ligjit, për të çuar përpara reformat e brendshme dhe për të arritur marrëdhënie të mira fqinjësore. Përparimi në të gjitha këto fronte është kyç për integrimin e plotë të kësaj pjese të rëndësishme të Evropës në familjen euroatlantike.", tha ai. "Ju mund të mbështeteni në NATO që ajo të vazhdojë të mbështesë aspiratat tuaja euro-atlantike dhe t'ju ndihmojë të ecni drejt një të ardhmeje paqësore dhe prosperuese për të gjithë. Politikat tona në rajon, përfshirë politikën tonë me Dyer të Hapura, ndihmojnë në forcimin e stabilitetit dhe ndërtimin e bashkëpunimit më të madh në Ballkanin Perëndimor", tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s.

Duke nënvizuar rëndësinë e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, Mircea Geoana, theksoi rolin dhe rëndësinë e misionit të KFOR-it në Kosovë, si një "rol themelor" dhe përmendi situatën e ditëve të fundit në Veriun e Kosovës. "Stabiliteti ka qenë gjithashtu prioriteti i misionit tonë të KFOR-it në Kosovë për më shumë se 20 vjet tani dhe ne mbështesim me vendosmëri dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe përpjekjet e tjera që synojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, si rruga e vetme përpara në arritjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme politike dhe stabiliteti për të gjithë rajonin. Kohët e fundit, ne pamë se sa i rëndësishëm ka qenë ky dialog për të zvogëluar tensionet në Veri të Kosovës. Unë mirëpres marrëveshjet midis Beogradit dhe Prishtinës për të gjetur një rrugë përpara dhe inkurajoj të dyja palët që të qëndrojnë në rrjedhën e dialogut. Ekziston një bashkëpunim i shkëlqyer midis NATO-s dhe BE-së në lidhje me Kosovën. Misioni ynë i KFOR-it po luan një rol themelor për të siguruar zbatimin efektiv të këtij aranzhimi në Veri të Kosovës, në përputhje me mandatin e tij në OKB.", tha z. Goeana.

Sfidat në Ballkanin Perëndimor dhe më gjërë

"Në një shkallë më të gjerë, në këtë botë të paparashikueshme, ne duhet të punojmë së bashku dhe madje edhe më ngushtë se kurrë më parë. Si aleatë dhe me vendet dhe partnerët e tjerë që ndajnë vlerat

tona, demokracinë, lirinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Sa më shumë të bashkëpunojmë, aq më i mirë është shansi që kemi për të mbrojtur mënyrën tonë demokratike të jetesës kundër atyre që përpiqen të na dëmtojnë". Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s theksoi sfidat në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe jo vetëm. "Ne përballemi me shumë sfida. Konkurrenca strategjike po rritet. Rusia është më shtypëse në vend dhe më agresive jashtë vendit, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Aktivitetet ushtarake dhe hibride të Moskës kanë për qëllim destabilizimin e shoqërive tona, minimin e institucioneve tona dhe dobësimin e sistemeve tona demokratike dhe besimin e qytetarëve tanë në rrugën e ardhshme. Kina po përdor fuqinë e saj ekonomike dhe ushtarake për të kontrolluar njerëzit e saj, për të detyruar vendet e tjera dhe për të vendosur kontrollin mbi zinxhirët e furnizimit global, infrastrukturën kritike dhe asetet e tjera. Përfshirë në rajonin tonë. Pekini po investon në porte, në hekurudha, në rrugë. Ai gjithashtu ka një prani në rritje të mediave në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe ndikon narrativën në avantazhin e saj. Ne gjithashtu përballemi me sulme kibernetike më të shpeshta dhe më të sofistikuara, kërcënime të vazhdueshme terroriste dhe natyrisht, ndikimet e sigurisë të ndryshimit të klimës", tha z. Mircea Goeana. Të gjitha këto sfida, tha ai janë shumë më të mëdha sesa çdo vend mund të përballojë i vetëm. "Nuk ka mënyrë më të mirë për t'u bërë ballë atyre, sesa të qëndroni së bashku. Dhe kjo është ajo që ne bëjmë në NATO. Duke qëndruar së bashku të 30 aleatët në çdo sekondë, në një logjikë dhe qasje 360 gradë". Kur aleatët u takuan në Samitin e NATO-s në Bruksel në qershor, "udhëheqësit tanë vendosën të forcojnë NATO-n edhe më shumë. Ata ranë dakord për NATO 2030, një agjendë ambicioze për sigurinë tonë të ardhshme dhe transformimin e përhershëm të aleancës sonë të madhe. Për të siguruar që së bashku, ne mbetemi gati për sfidat e sotmes dhe ato të së nesërme.

Konkretisht, ne vazhdojmë të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë në vend. Duke shpenzuar më

shumë për mbrojtjen, duke investuar në aftësi të nivelit të lartë dhe duke rritur më tej gatishmërinë e forcave tona", tha ai.

"Në të njëjtën kohë, si pjesë e NATO 2030, ne po forcojmë elasticitetin tonë, duke rritur mbrojtjen tonë kibernetike dhe duke adresuar ndikimin e ndryshimit të klimës në sigurinë tonë. Ne po investojmë në teknologjitë më të fundit, për të mprehur avantazhin tonë teknologjik dhe për të ruajtur epërsinë tonë teknologjike. Së bashku, ne do të vazhdojmë të trajtojmë paqëndrueshmërinë, të luftojmë terrorizmin dhe të ruajmë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke rritur trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për partnerët dhe duke thelluar marrëdhëniet tona me vendet e tjera, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe institucionet akademike". Duke u ndalur në sektorin privat dhe institucionet akademike ai theksoi se "në këtë kontekst global, i cili po ndryshon, mënyra më e mirë për të ecur përpara është të sigurohemi që kjo treshe midis sektorit publik, qeverive tona, institucioneve tona shtetërore, sektorit tonë privat dhe akademisë sonë dhe shoqërisë civile të punojë më afër së bashku se kurrë më parë. Kjo është ajo që ne bëjmë në inovacion, kjo është mënyra për të bërë për t'u siguruar që Aleanca jonë të përshtatet me këtë mjedis shumë kompleks në të cilin po jetojmë", tha ai. "Kjo është arsyeja pse Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, dhe unë vetë do të punojmë ngushtë me të gjithë aleatët ndërsa ne e çojmë këtë agjendë ambicioze përpara dhe përgatitemi për Samitin në Madrid në fund të qershorit 2022." Z. Goeana tha se "Mali i Zi është një komb shumë mbështetës i NATO 2030", dhe në përfundim të fjalës së tij tha se "kam besim se ju dhe të gjithë aleatët e tjerë, do të mbeteni të angazhuar në mënyrë aktive ndërsa ne i kthejmë vendimet e NATO 2030 në veprim. Ndërsa po fillojmë një proces konsultimi dhe negociatash për Konceptin e ri Strategjik, ndërsa ne po përgatisim Aleancën tonë të madhe, tani më shumë se shtatë dekada të vjetër, për të qëndruar të rinj dhe për të investuar në dekadën e ardhshme të kësaj Aleance tonë të veçantë."

PARTIZANI

Historia e skuadrës së futbollit dhe zanafilla e saj

PËRGATITI: ANJEZA MUSOLLARI

Historia e skuadrës së futbollit "Partizani" zanafillën e saj e ka pas çlirimit të vendit. Bazë për krijimin e saj ishin të rinjtë partizanë të divizioneve, të brigadave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në vitet e para shkolla "Skënderbej" dhe "Shkolla e Bashkuar e Oficerëve" si dhe futbollistë të skuadrave të tjera do të ishin furnizuesit e saj kryesorë. Në kampionatin e parë të kategorisë së parë të pasluftës, në vitin 1944 do të merrnin pjesë dy divizione të ushtrisë, njëra me qendër në Shkodër "Ylli" dhe tjetra me qendër në Korçë "Liria". Këto dy skuadra ushtarake do të merrnin pjesë vetëm në kampionatin e parë, pasi në vitin 1946 këto skuadra me futbollistët më të mirë krijuan bërthamën e ekipit kryesor të skuadrës ushtarake e cila mori emrin "Ushtria".

Më 13 janar 1946, ekipi zhvilloi takimin e parë miqësor ndaj kampiones së vendit në vitin 1945 "Vllaznia".

Ndeshja u zhvillua në Tiranë, edhe pse në kushte të vështira atmosferike (shiu i dendur), ndeshja u mbyll me rezultatin 0-0. Skuadra ushtarake dallohej nga inicialet e germave që ishin vendosur në gjoksin e secilit futbollist.

Formacioni historik i saj ishin: Fagu, Demneri, Teliti, Luga, Bonati, Kavaja, Bakalli, L.Hoxha, Bylyku.

Ndërsa më 7 prill 1946 skuadra e cila kishte luajtur nën emrin

Nga uniforma ushtarake, nën fanellën e kuqe të Partizanit, fitues të 16 titujve kampionë

"Ushtria" në këtë takim kundër "17 Nëntorit" të Tiranës, për herë të parë në bluzat e tyre ishte shkruar "Partizani". Takimin e fitoi ekipi i "Partizanit" me rezultatin 2-0, shënuesit ishin futbollistët O.Pengili

dhe Q.Teliti.

Partizani – Hanoi në 1963

Formacioni që luajti për fanellat e kuqe Çobani, Tepeli, Dibra, Fagu, Kavaja, Pengili, Hoxha, Sakiqi, Bylyku, Demneri. Në kampionatin kombëtar





të kategorisë së parë të vitit 1946, skuadra ushtarake "Partizani" nuk ishte pjesëmarrëse. Por për të mos qëndruar pasive, skuadra ndërmori një turne të gjatë në shumë qytete të Shqipërisë për konsolidimin e ekipit por dhe për të parë futbollistë cilësorë të këtyre qyteteve. Zhvilloi 9 ndeshje miqësore, duke shënuar 26 gola e pësuar 9. Shënuesi më i mirë ishte Qamil Teliti me 11 gola. Viti 1947, për herë të parë merr pjesë në kampionatin kombëtar të vendit dhe për herë të parë shpallet kampion kombëtar, titull që do ta mbronte dhe në kampionatet e viteve 1948 dhe 1949. "Partizani" fitoi dhe 2 kupa të Shqipërisë në vitet 1948-1949. Skuadrën e ka drejtuar trajneri Sllave Llambi që gjithashtu ishte futbollist i skuadrës.

Historia e skuadrës së futbollit "Partizani" gjatë periudhës 73-vjeçare ka qenë vazhdimisht në rritje, me fitimin e 16 titujve kampion kombëtar, të 15 kupave të Shqipërisë, 2 Superkupa, e të shumë takimeve ndërkombëtare, por për t'u theksuar është fitimi i 2 medaljeve të argjendit në Laipçig dhe Hanoi ndaj skuadrave më në zë të Europës Lindore. Skuadra e Partizanit me futbollistët cilësorë ka përbërë bazën e skuadrës kombëtare. Në 68 vite me skuadrën, kanë dhënë kontributin e shquar dhjetëra futbollistë.

Skuadra e Partizanit për shumë vite jo vetëm ka fituar tituj kampion dhe Kupa të Shqipërisë, por ajo i ka paraprirë futbollit shqiptar .

Janë shumë mjeshtra të merituar dhe dhjetëra mjeshtra sporti që kanë dalë nga radhët e skuadrës së Partizanit. Shumë nga ish futbollistët e Partizanit kanë veshur fanellat e ekipeve të huaja si në Itali, Gjermani, Greqi, Turqi, Zvicër.

Përveç se ka qenë nga skuadrat

kryesore në Shqipëri, Partizani ka qenë dhe një nga skuadrat më të suksesshme edhe në arenën ndërkombëtare, duke arritur disa rezultate historike dhe më kryesisht duke ngritur të vetmin trofe ndërkombëtar në historinë e skuadrave shqiptare, Kupën e Ballkanit.

Tre djem "tironsa", Fagu-Demneri-Bylyku, themeluan në vitin 1946 Klubin Sportiv "Partizani", atë që do të bëhej rivali më i madh i bardhë e blu të Tironës?! Entuziazmi i atyre viteve, me dëshirën për të krijuar mrekullira nga hiçi, është me të vërtetë për t'u admiruar. Personalitete të tilla si Besim Fagu, që krijuan për radhët e ushtarakëve shqiptarë, një strukturë profesioniste sportive, janë në panteonin e njerëzve, kontributi i të cilëve është bërë pikë reference për brezat e ardhshëm. Ishte Besim Fagu dhe shokët e tij që e bënë Klubin "Partizani" një organizëm elitë të sportit dhe fizikulturës në Shqipëri. "Partizani" ka qenë një shkollë e jetës për shumë e shumë breza të shquar ushtarakësh e sportistësh.

Besim Fagu lindi në qytetin e Tiranës në vitin 1925 dhe vdiq në vitin 1999. Fill pas luftës, ku ai ishte inkuadruar partizan, u lidh përjetësisht me ushtrinë dhe sportin. Ai është padyshim një nga lojtarët e rrallë jo vetëm në Shqipëri, por edhe më tej për numrin e madh të kampionateve të fituara me një skuadër. Besimi ka luajtur për klubin e kuq për 12 vite rresht. Mbrojtësi shtatlartë i "Partizanit" do ta mbyllte karrierën e tij të suksesshme me tre tituj rresht në 1957, 1958 dhe 1959, duke e çuar në shtatë numrin e trofeve me "Partizanin". Gjatë kësaj periudhe, përveç shtatë titujve, Besim Fagu ngriti edhe katër herë Kupën e Shqipërisë. Gjithashtu

Besim Fagu ka qenë pjesë e trofeut të vetëm ndërkombëtar të Shqipërisë, pasi fitoi Kupën Ballkanike me kombëtaren në 1946. Ai është themeluesi dhe drejtuesi për shumë vite i klubit sportiv "Partizani", një ndër klubet më me emër në historinë e sportit shqiptar.

Xhavit Demneri (Partizani, 17 Nëntori) – Mesfushor, 1.69 m, emër i madh për vitet para, pas luftime, kampion me Kombëtaren e '46-tës, më pas trajner i suksesshëm, zbulues talentesh nga më të spikaturit. Protagonist i skuadrës ushtarake në krah të Panos, titullar dhe kampion me Partizanin në finalen e dyfishtë më 1961, ndaj Dinamos. Autor i disa librave historike për sportin etj.

Xhavit Demneri, një nga kolosët e futbollit për të rinj, "USTAI", i cili përkëdheli që në hapat e para gjithë ato talente të padiskutueshëm, sidomos të kryeqytetit, nuk jeton më. Është emri që ai ka lënë ndër brezat e futbollistëve që e lartëson këtë figurë.

Futbolli i të rinjve është fidanishte, gurra e pashtershme e asaj perspektive për çdo individ e skuadër, që nxiste e nxit karrierën ku shkëlqimi i kujtdo s'ka ardhur spontanisht.

Xhavit Demneri është trashëgimia më e gjallë dhe më e freskët e rrugës së përshkuar sidomos fillimeve të kampionateve për të rinj. 14 herë kampion kombëtar, dhjetëra suksese shumë domethënëse, që qëndrojnë përbri rezultateve të tjera, kanë lidhje me afrimin e talenteve brilante.

Parë kështu, mesazhi për të gjithë ata që kanë qenë e do të jenë protagonistët e futbollit për të rinj, është më se i qartë.

Nderimi dhe respekti për kontributin e dhënë!

Intervistë me Ilir Këllezi triumfuesin e “Maratonës së Tiranës 2021”

Maratonomaku korçar fituesi i disa medaljeve

Kam një kohë të gjatë që merrem me stërvitje, punë e palodhur, me kërkesa të shumta ndaj vetes. Njeriu zotëron shumë energji të panjohura brenda tij. Dëshira dhe vullneti për të përballuar ngarkesat e mëdha fizike gjatë stërvitjes janë çelësi kryesor i motivimit dhe i realizimit të objektivave.

Edhe një herë tjetër qyteti i Korçës tregoi se lind dhe rrit njerëz që e duan artin, të bukurën apo sportin. Një qytet që personifikon bukurinë dhe krenarinë shqiptare, përkatësisht djepin e trashëgimisë sonë kulturore. Një qytet i cili mbart zanafillën e dijes, shkollës së parë shqipe “Mësonjëtores”, por që ka treguar se ka dhe njerëz që e duan sportin dhe i janë përkushtuar atij, bëhet fjalë për atletin Ilir Këllezi pjesëmarrës në Maratonën e Tiranës i cili u shpall fitues në 42 kilometra. Maratona u mbajt në datë 17 tetor ku morën pjesë 2500 vrapues shqiptarë dhe të huaj vendin e parë për meshkuj e fitoi Këllezi, të dytin maqedonasi Igor Jakimovski, kurse për

kategorinë e femra atletja ukrainase, Valentina Veretska dhe në vend të dytë atletja shqiptare Luiza Gega. Ilir Këllezi, pjesë e QKMBMMFA-së në sektorin e sporteve dhe aktiviteteve në Ministrinë e Mbrojtjes. Merret me sport prej 18 vitesh ka qenë pjesëmarrës në disa gara jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj si: Lojërat Olimpikë Evropiane në Baku, Azerbajxhan 2016 Lojërat Olimpikë Mesdhetare në Mersin, Turqi 2012 dhe në Lojërat Olimpikë Universale në Shenzhen, Kinë 2011. Gjithashtu në vitin 2019 ka marrë pjesë në garën që u zhvillua në Greqi, në qytetin e Janinës ku u rendit i pari në 600 garues. Momentalisht është duke u përgatitur për sfidën e radhës Kampionatin Evropian të Krosit në Dublin të Irlandës. Për më shumë detaje të jetës si atlet dhe kontributin e tij në atletikën shqiptare realizuam një intervistë...

Si i kujtoni fillimit tuaja si vrapues?

Isha shumë i ri kur fillova të merresha me sportin e atletikës rreth moshës 14 vjeçare. Si fillim organizoheshin aktivitete sportive midis shkollave dhe ndër to ishte dhe atletika. Fill pas fitoreve që merrja nëpër shkolla u motivova më shumë dhe vendosa të vazhdoja edhe më tej.

Çfarë ju shtyn të merreni me këtë sport, me atletikën?

Atletika është një sport i bukur, garë individuale që edhe stimujt i fiton në mënyrë individuale, kjo më shtyn të kërkojë edhe më shumë nga vetja.





Prej 18 vitesh ju merreni me sport si do ta këshillonit dikë i cili dëshiron t'i bashkohet atletikës, që dhe ai si ju të zotërojë me sukses edhe distancat më të mëdha?

Kam një kohë të gjatë që merrem me stërvitje, punë e palodhur, me kërkesa të shumta ndaj vetes. Njeriu zotëron shumë energji të panjohura brenda tij. Dëshira dhe vullneti për të përbulluar ngarkestat e mëdha fizike gjatë stërvitjes janë çelësi kryesor i motivimit dhe i realizimit të objektivave.

Ju arritët që të fitonit “Maratonën e Tiranës 2021” 42 kilometra sa e rëndësishme ishte kjo fitore në këtë moment të karrierës suaj? Si e përjetuat?

Që në fillimet e karrierës sime unë i kam vendosur objektiv vetes “të arrij gjithmonë majat” dhe rezultatet e mëparshme më motivuan të stërvitem rregullisht, intensivisht për çdo kompeticion. Bashkë me trajnerin tim mundohemi që të bëjmë më të mirën e mundshme për të arritur rezultat. Unë personalisht stërvitjen e konsideroj si garë me konkurrencë të fortë. U ndjeva shumë i lumtur, pasi ishte gara më e rëndësishme e maratonës, por dhe më i përgjegjshëm, pasi ishte edhe më e vështirë si garë.

Çfarë e bënë të veçantë pjesë-

marrjen në një garë si “Maratonë e Tiranës 2021”, e cila u zhvillua për të pestin vit?

Ishte një aktivitet ndryshe nga vitet e tjera, sepse pikërisht këtë vit u realizua maratona e plotë e Tiranës dhe u certifikua nga Federata Botërore e Atletikës. Gjithashtu organizimi ishte më i realizuar nga vitet e tjera kishte atletë nga 35 shtete të botës rreth 2500 garues që përfaqësonin ajkën e atletikës.

I dyti në maratonë u rendit Igor Jakimovski nga Maqedonia e Veriut si ishte gara mes jush?

Aktualisht me Igorin jemi miq të mirë prej kohësh, por edhe rivalë njëkohësisht. E vlerësoj për shpirtin e garës që jep në çdo aktivitet dhe e quaj një kundërshtar të denjë. Për sa i përket maratonës së Tiranës me Igorin kishim të njëjtin ritëm, në kalimin e kilometrave Igori mbeti disa minuta pas. Në malore pata një shkëputje dhe më pas vazhdova me të njëjtin ritëm.

Cilën nga pjesëmarrjet tuaja në gara, apo aktivitete do ta quanit suksesin tuaj më të madh?

Suksesin më të madh e kam arritur në disa aktivitete si: Lojërat Olimpikë Evropiane në Baku Ajzerbaxhan 2016. Lojërat Olimpikë Mesdhetare në Mersin, Turqi 2012 dhe në Lojërat Olimpikë Universale në Shenzhen Kinë 2011.

Medalja më e rëndësishme për ju në cilën maratonë është fituar?

Në fakt janë disa medalje që dua ti veçojë, e para në Jerevan të Armenisë në të cilën jam renditur i dyti në 5200 garues në vitin 2016. Në vitin 2017 mora pjesë në maratonën e Selanikut ku ishim 3000 garues atje u rendita i treti. Kurse në vitin 2019 mora pjesë në garën që u zhvillua në Greqi, por këtë herë në Janinë ku u rendita i pari në 600 garues.

Gjatë garës emocionet janë të forta, sidomos kur jeni shumë pranë finishit, cili është në të vërtetë momenti juaj i preferuar dhe pse?

Të jem i sigurt që kur nisem në momentin e fillimit të garës shkëputja nga garuesit e tjerë më jep më shumë motivim të vazhdoj garën me ritme më të larta dhe të arrij sa më shpejt drejt finishit, sepse me shpërblehet i gjithë mudi dhe koha e investuar.

Në karrierën tuaj numëroni disa medalje, por shpirtin e një atleti e mbajnë gjallë sfidat e vazhdueshme, cila është sfida juaj e radhës?

Sfida ime e radhës është Kampionati Evropian i Krosit në Dublin të Irlandës, në dhjetor.

**Intervistoi:
Hajrie Dedaj**


KAREMAN HASKO

Doktori i Pilotëve ushtarakë shqiptarë

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Kareman Abas Hasko (Aliaj) është një emër i njohur i aviacionit ushtarak shqiptar. Ai nuk ishte pilot, por mjek ushtarak, mjek i tre aerodromeve. Ai përgatiste djemtë e kaltërsive, i niste dhe i priste plot emocion, djemtë e Shkollës së Aviacionit, i dërgonte në fluturime të ëndërrimeve të bardha edhe pse me mision luftarak. Ai ishte dhe mbeti shpirti plot emocion i studentëve për pilotë, që çanin kryq e tërthor qiejt e kaltërsive dhe bardhësinë e reve, pilotonin guximshëm në prehër të qiellit dhe riktheheshin buzagaz tek kontrolli mjekësor i doktor Kareman Haskos. Edhe pse me emër hero i nuk u ndje kurrë hero por mbeti njerëzor deri në frymën e fundit. I njëjti emër për emër gjithë pilotët, "kishin shkuar në dorë të tij", i kishte matur emocionet si askush dhe u kishte dhënë leje të ngriheshin në kaltërsitë e Republikës. "Varka" e jetës së tij u mbush me vite, me njerëzillëk, me halle e shpresa, ku mbizotëroi gëzimi. Buzëqeshja e shpirtit ja kalon çdo lloj buzëqeshjeje. Prandaj mbeti përgjithmonë sikurse thotë i biri, Astriti, "i thjeshtë, i durueshëm, i respektueshëm, korrekt, i dashur, i ndershëm, i drejtë, i zoti, kurajoz, optimist, i kulturuar, i sakrificës e familjar shembullor" Doktor Karemani jetoi një jetë krenare, dinjitoze duke materializuar njerëzoren dhe shpirtbardhësinë. Prandaj shprehja "bëmë Baba të të ngjaj" është plotësisht e materializuar dhe e vërtetuar si një aksiomë popullore e pagabushme. Doktor Karemani ishte një misionar në jetë dhe këtë mision e vijon Astriti. Po edhe e tejkalon kur

(Në kujtim të Kareman Hasko (Aliaj), partizanit pionier, doktorit të radhëve partizane, doktorit ushtarak të pilotëve që na rikthehet nga kaltërsitë e qiellit shqiptar nga pena e të birit Astrit Aliaj me libër të posaçëm dhe të dedikuar "Mjeku i kaltërsive", një libër-përmendore për kujtimin e tij njerëzor. Ai ishte lindur më 6.1.1928, ishte rreshtuar në radhët partizane, në Br23S, infermjer, ndihmësmjek, student në ish-Jugosllavi (Boegrad dhe Lubjanë) nga dhjetori 1947 deri në Maj 1948 dhe në ish-BRSS (Kiev) nga 19.9.1948 deri më shtator 1951, vit kur ju dha edhe grada "nëntoger" dhe doktor ushtarak, gjithçka e dokumentuar në dosjen personale me nr. 7372 të oficerit doktor Kareman Abas Hasko (Aliaj). Edhe aparati i librit është një gjetje e spikatur për monografinë "Një jetë kushtuar mjekësisë", ku përfshihen edhe art grafik dhe kopertina nga Alketa e Dorela Aliaj si dhe redaktimi nga mjeshtri Kristaq Shabani që ka shkruar dhe përsiatjen: "Profil "obelisk" i spikatur i mjekut me shkathtësi mendjeje dhe shkathtësi veprimi profesional". Doktor Kareman Hasko (Aliaj), përmbushi me nder "betimin e Hipokratit" pikë për pikë duke e kaluar jetën si mjek profesionist, në pastërti dhe dlijësi, dhe kështu ai mbeti deri në ditën e dëshmorëve të 2018-ës dhe përgjithmonë mirënjohje, nder, krenari e Aviacionit Ushtarak, por dhe mbarë trevës së Labërisë).



nuk lejon që një jetë e gdhenur në dashuri njerëzore e babait e sjell në një libër të posaçëm për të: "Një jetë kushtuar mjekësisë", Kujtimet e mjekut të aviacionit Kareman Abas Hasko (Aliaj). Prandaj edhe bilbili i gjuhës shqipe Naim Frashëri

shkruante: "Mos thuaj se vdes njeriu./Se, është fjalë çilimiu./Tek i biri, jetëgjati./Është mbëshehur i ati.". Jeta e doktor Karemanit është një "ditar", që edhe pse e ka shkruar vetë, në pentagramin e shpirtit ja hedh në letër i biri. Ku

ka më bukur! Kështu jeton e gjallon më gjatë, por dhe shtrihet në të gjithë brezat që e trashëgojnë mirësinë e tij. Lumturia e agimeve të brezave të së ardhmes do "kulllosin" shpirtin qetësisht në hijet e ëmbëla të së kaluarës. Kështu kujtimi i dr. Karemanit do të jetë dhe më afër, dhe më i prekshëm, këshillues, i përjetshëm si dëshira e njerëzve të zemrës si dhe shokëve, miqve e kolegëve të tij. Dhe brezat që do të vijnë do të dinë ta "ndezin" jetën nën dritën e qiririt të mirësisë që nuk fiket kurrë, që dhe brezat të përjetojnë emocione të papërmbajtshme jetësore si emocionet e ndjenjat njerëzore të brezit të hekurt të doktor Karemanit, këtij obelisk me mendje të shkathët dhe profesionist i mjekësisë e shpirtave njerëzorë. Libri i Astrit Aliaj është përshkruar me vërtetësi jetësore, plot çaste lumturie dhe krenarie të ligjshme, që përcjellin besim dhe shpresë, të epokës mjekut të pilotave, besim e shpresë që do të vijojë edhe në këtë botë të mbushur me kompleksitet. Libri është original për një jetë të jetuar vrullshëm në të gjithë dimensionet jetësore larg mbingarkesave e sforcimeve, por e mbushur me dokumente arkivore e familjare. E bukura qëndron tek e thjeshta dhe e mira, plot ndjenjë dhe njerëzore. Libri memorial kujtese për doktor Karemanin është një etalon mirësie, prush atdhetarie, shembull që transmeton mesazhe të fuqishme të dashurisë njerëzore, për mënyrën e depërtimit në botën njerëzore me thjeshtësi dhe dashuri. Ky ishte një "provim" i vështirë për shokun tonë Astritin (autorin e librit), që në 360 faqe të librit "Një jetë kushtuar mjekësisë", në të tetë pjesët e tij, ka përmbushur me sukses të plotë, një ndër detyrat më të vështira të jetës së tij.

Sevasteri, fshati i lindjes dhe origjina

Kushdo ka kaluar në Sevaster, i ka rënë në sy nyja e hershme historike si një kala natyrore, që lidh gjithë Shqipërinë jugore, sepse rruga nëpër shekuj kalonte faqes së malit, për në Tepelenë, Memaliaj, Gjirokastër, Janinë, Selanik e më tej, në qendrën e Perandorive. "Rapi i Sevasterit", ishte pika turistike me ujin e ftohtë, ku qëndronin nëpunësit e kohëve antike që i dhanë edhe emrin fshatit, stacioni ku ndalonin autobusët,

pushonin, udhëtarët, fshati me postë-telegraf, qytezë rrëzë Tarrarit, fshat me shkollën: "Drita e Diturisë" ndër të parat dhe të rrallat në Vlorë, me njerëz drejtues me zë, specialiste e kapacitete, në shumë fusha, me gjurmë thesar për origjinën të gdhendur në Amfiteatrin e kësaj treve me tradita të çmuara të rralla, të ruajtura, pasuruara dhe transmetuara nëpër breza shekujve. Këtu në këtë fshat ishte lindur Kareman Abas Hasko (Aliaj), që vjen për shokët, miqtë, kolegët në librin e Astrit Aliaj "Një jetë kushtuar mjekësisë". Pjesa e parë "Fëmijëria" vjen e përshkruar në mënyrë emocionale që sikurse thotë redaktori i librit Kristaq Shabani, "ka arritur në skalitjen e profilit, një detyrë sa e vështirë, aq dhe e përgjegjshme". Vendlindja, pozicioni gjeografik, vlera e qyteti Amantia, qytet i lashtë, vërtetues i faktit të lashtësisë së banorëve të këtyre trojeve dhe aspektet e zhvillimit kulturor, prejardhja e emrit të fshatit Sevaster, bazuar në të dhëna arkeologjike e shpjegime etimologjike; paraqitja e ardhjes në jetë dhe jeta zanafillore e Karemanit, ku jepet dhe një "organogramë" e pemës gjenealogjike e familjes, fisit...". Në këtë libër tradita, zakonet, doket, përshkrimet e përfaqësuesve të brezave të familjes, mjediseve banuese si dhe të dhënat bibliografike të bazuara fuqishëm në dokumenta arkivore e bëjnë publikimin serioz dhe mjaft të besueshëm. Prioriteti dhe dashuria për arsimimin, të dëshirës së gjithë trevës për dije e arsimim, të bindin në idenë e rrugëtimit të ardhshëm që e fton lexuesin të jetë besnik librit për njohuritë që vendos në dispozicion serviren duke marrë përmasën e nevojshme për të realizuar tejnjohjen. Karemani fëmijë e ndjente veten të bekuar për vendlindjen e tij dhe dashurinë për të e kishte të shenjtë, sepse në ditë të shenjtë kishte lindur. Këtë vend të bekuar bashkëfshatarët e tij e kishin ngritur në art, kur këndonin: "Sevaster-Kudhës Grehoti,/o vend i bekuar nga Zoti". Bijtë e Sevasterit e dinin mirë se një popull pa kulturë e shkollë sundohet lehtë nga të huajt, prandaj përpjekjet dhe lufta për çeljen e shkollës, kanë qënë pjesë e luftës për të siguruar lirinë e mëvehtësinë për këtë krahinë, të njohur për zhvillimet historike, dhe që quhej "Kudhës Grehot",

përpara vitit 1945. Fakt është se për përhapjen e gjuhës shqipe, çeljen e shkollës së parë në këtë trevë, ndër 10 shkollat e para në qarkun e Vlorës, ku përmblihte mbi 9 fshatra në kufijtë e Vlorës me Tepelenën dhe Mallakastrën, shënohet në memorijen e njerëzve, viti 1911, kur njihet hapja e shkollës së Sevasterit e transmetuar brezave, e njohur historikisht dhe e pasqyruar edhe në shtypin e kohës. Fëmijëria është një stacion në udhën e jetës dhe është në fakt pranvera e shpirtit, përjetimi më njerëzor i halleve dhe brengave të kohës të cilat Kareman Hasko (Aliaj) i përjetoi sikurse gjithë bashkëmoshatarët e tij. Kapitulli "Fëmijëria" është mbushur me emra e detaje, një mekanizëm i domosdoshëm informativ për lexuesin, që në rreth shtatëdhjetë faqe mbyllet me pushtimin fashit italian, që edhe pse Karemani ishte në klasën e tretë si gjithë bashkëmoshatarët, ishte koha kur nuk kishte më fëmijëri. Fëmijëria e kishte humbur kuptimin dhe nocionin e të qenit e tillë. Kishte ardhur koha e burrërimit të parakohshëm, kur robëria kërkonte kundërpërgjigje, për të rrëmbyer armët sikurse kishin bërë ballarët e tyre në vitin 1920 dhe në luftat e tjera për liri.

Antifashizmi trend i kohës dhe detyrim për çdo shqiptar gjatë LLIB

Pjesëmarrja në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) është pjesa e dytë e librit, ku "Dashuria për Atdheun, lind nga dashuria për familjen" është e përshkruar me "kohë e zezimit", që është "pushtimi kulturor" italian fashist, që në fakt krijoi stanjacion dhe robëroi shqiptarët. Në libër del në pah aktiviteti patriotik në çetën e Sevasterit, por nuk ngurohet dhe hapur flitet edhe për pjesëmarrje të "gabuar" në formacionet e ish-Ballit Kombëtar, e justifikuar nga fakti që vinte nga mituria. Por sikurse shpjegohet në rreshtat e librit solli pasoja të shumta, sorollatje, jo pak andaralla për doktorin deri në mos praninë në partinë e asaj kohe, gjatë gjithë jetës, paçka se në fakt ishte larguar nga formacionet e Ballit dhe kishte përqafuar idealet antifashiste të partizanëve shqiptarë, duke ju bashkuar partizanëve të Brigadës së 23-të Sulmuese. Në fq 86, flitet qartë për ngjarjen e qershorit të

vitit 1944 ku kushëriri Çuman Mehmeti (Aliaj), bënte pjesë në çetën e Ballit në Amonicë dhe prej Amonicës shkuan në Kropisht e në Vlorë, duke e marrë edhe Karemanin me vete në atë kohë një 15 vjeçar. Ndërkohë që është më se e njohur se aktiviteti i kësaj brigada sikurse gjithë brigadat e tjera ka qenë mjaft i suksesshëm gjatë LANÇ-it edhe përtej kufijve administrativë shqiptarë. BrXXIIS ishte formuar në Zall-Mner të Tiranës, më 21.9.1944, nga batalionet "Krujë-Ishëm", "Dajti", e "Mati" dhe që kishte rreth 700 partizanë të organizuar në tri batalione. Që me krijimin u fut në përbërjen e DIS, ku mori pjesë në luftën e Tiranës. Forcat e saj për afër dy muaj rresht goditën autokolonat gjermane në rrugën Vorë-Milot, si dhe garnizonet e fortifikuara të armikut në Krujë, Vorë e Ura e Zezë. Ndërkohë shpartalloi forcat e Legalitetit në zonën e Ishmit dhe me veprimet e saj luftarake bëri që 400 forca të tyre të dorëzoheshin. Në fund të muajit tetor organizoi mbrojtjen e bregdetit në zonën e Ishmit, për të ndaluar çdo zbarkim të mundshëm të forcave anglo-amerikane në atë drejtim. Pas goditjeve të ashpra e të vijueshme, më 1 nëntor 1944 çliroi Krujën. Me urdhër të Shtabit të Korparmatës IS më 17.11.1944 BrXXIII S në bashkëveprim me BrXXIV S vazhdoi ndjekjen e forcave gjermane që po tërhiqeshin në rrugën Milot-Lezhë-Shkodër, duke i shaktuar armikut humbje të mëdha, më 18 nëntor '44 çliroi Milotin, më 23 nëntor '44 Lezhën dhe së bashku me forcat e disa brigadave të tjera, mori pjesë në çlirimin e Shkodrës. Me urdhër të Komandës së Përgjithshme, kaloi kufirin shtetëror dhe vazhdoi veprimet luftarake në Mal të Zi bashkë me BrVIIS e BrXXIVS për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë, kryesisht të shqiptarëve që jetonin në këto troje. Në faqet e librit lexuesi gjen të faktuar rrugëtimin e Karemanit dhe kalimin me forcat partizane, kur ranë nën breshëritë e plumbave të nazistëve gjermanë në Shkodër. Por fakt është se "incidenti" me forcën kundërshtarë politike që humbi luftën dhe u bashkua me pushtuesin e ndoqi pas si një "hije e zezë", si një damkë biografike edhe pse rrugën e jetës e çau me guxim dhe zotësi. Ndërkohë që është i njohur

se gjithë fisi dhe fshati i Karemanit kishte përçafuar fuqishëm luftën partizane si pjesë e kolacionit të madh antifashist botëror. Vëllai i tij Tefiku ishte partizan i BrVVS hero i popullit. Edhe pse me "njollë në biografi" Karemanin dhe shokët e tij i përballuan me nder sfidat më të mëdha të jetës: "luftën partizane" dhe dolën fitimtar në një Shqipëri të sflitur por të lirë.

Shkolla – kudhra ku u përgatit e ardhmja e doktorit të pilotëve

Kareman Hasko (Aliaj) është pjesë e historikut të aviacionit, është një copëz e jetës qiellore shqiptare. Paslufta ishte një oqean pafundësish perspektivash për t'u shkolluar dhe rritur profesionalisht, dhe për të gjetur veten në shoqëri. "Rruga drejt mjekësisë", "Kthimi në Atdhe dhe fillimi i karrierës ushtarake", "Martesa dhe karriera", "Fillimi i jetës bashkëshortore", flasin për thelbin e jetës dhe burërimin në shkollin dhe profesion por edhe në jetën familjare, për detyrimet e mëdha në jetë që vijnë kaq pozitivisht dhe me ndjesi reale dhe vërtetësi jetësore. Nuk ishte më partizani i thjeshtë, infermieri partizan, ndihmës mjek në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë, por student për mjekësi, nëpër fakultete në Beograd, Lubjanë, në Kiev, në Tiranë, mjek në tre aerodrome, mjek në Shkollën e Aviacionit në Vlorë deri në daljen në pension, duke e përmbyllur me krak-pensistikën figurative: "T'i linde në ditën e "Ujit të Bekuar", u largove në ditën që nderojmë Dëshmorët e Atdheut".

Libri i Astrit Aliaj është një qëmtim plot sqimë në përditshmërinë e jetës, në emocione, gëzime, trishtime, guxime, në luftën për për dije e profesionalizëm, në botën e madhe të pamatë shpirtërore, në zbatueshmërinë e betimit "vargmal" të Hipokratit, babait të mjekësisë në botë, në bardhësinë e bluzës por më shumë në bardhësinë e karakterit dhe të figurës intelektuale e fisnike, në interesimin për shëndetin, rigorozitetin profesional, në përkushtimin ushtarak. Ai punoi dhe jetoj në një periudhë kur aviacioni e filloi nga zerua dhe u ngjit në majat e lavdisë së kohës me rreth 240 mjete ajrore avionë e helikopterë, një flotë e jashtëzakonshme për kohën dhe për mundësitë shqiptare. Shqipëria pati një Shkollë të Aviacionit, në historikun e së cilës

shkruajti bindshëm emrin Kareman Aliaj. Një shkollë që do të jetojë gjatë në kujtesën shqiptare dhe nuk dihet se kur do të ketë sërish një të tillë. Aviacioni, për nga natyra tepër i veçantë me njerëz të veçantë, që kërkonte shumë trajnim e sakrificë rigorozitet dhe kërkesë të lartë sepse fiziologjia e fluturimit, dhe sidomos ajo për përdorim luftarak kërkonjë elementët më të mirë psiko/fizike të njeriut. Këto element pilotët tanë i morën fillimisht në shkollat e aviacionit jashtë në ish-Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, meqenëse atje ofroheshin kushtet më të mira për trainimin e pilotëve luftarakë. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik në baza ideologjiko-politike, ashtu si edhe me fushat e tjera të ekonomisë, ushtria filloi të vuante menjëherë pasojat e prerjes së ndihmave ushtarake sovjetike. Por sektori që ndjeu më shpejtë mungesën ishte aviacioni. Prandaj edhe lindi nevoja e një shkolle për pilotë në vendin tonë dhe sigurisht edhe mjekun e donin shumë të përgatitur dhe kompetentë. Ishte periudha kur Ushtria Popullore kishte nevoja emergjente për furnizimin me gjak të ri të radhëve të aviacionit ushtarak, por dhe ideologjia e kohës, "Të mbështetemi në forcat tona". Kështu u vendos krijimi i një shkolle e cila kishte rol kyç në përgatitjen e pilotave dhe të teknikëve të aviacionit ushtarak, sipas përvojës së marrë nga shkollimet në ish-BRSS. Më 11 Maj 1962, me dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, u vendos hapja zyrtare e Shkollës së Lartë Ushtarake të Aviacionit. Pilotët përgatiteshin me një program dy vjeçar, kurse pas vitit 1964 programet e shkollës u ngritën në nivel tre vjeçar. Në vitin 1976, Shkolla e Lartë Ushtarake e Aviacionit, sipas kërkesave në rritje të armës së aviacionit, u bë institucion me program tre vjeçar për gjithë specialitetet, ku shkollës i shërbente si pistë e dheut në Pish Poro (Akërnj) e vendosur pranë Lagunës së Nartës në veri të qytetit të Vlorës, e ndërtuar më 1950 dhe shërbente si bazë rezervë e Regjimentit të Kuçovës. Komandanti i parë i shkollës ka qenë kolonel Babaçe Faiku, me kontribut të madh në formatimin e shkollës që ishte njëherazi edhe mik e shok me doktor Karemanin. Studentët e parë të aviacionit



shqiptar, si Koço Biku, Bardhyl Lubonja, J. Bakshevani, P. Lengu, Sefedin Tomçini (dëshmor), Petraq Korovesi, Thanas Papa, Foto Lako, S. Shahini, Kostandin Sadiku, Flamur Micko, Nehar Jazenxhiu, Naun Todo, Haki Jupasi, Mahmut Hysa, Bardhosh Hasani, Hasbi Serani, Avdi Gjomema, Agim Nanaj, Kaso Petroshati, Hamit Ulqinaku, Guri Merko, Petrika Kostani, Arqile Kosta, Servet Murati, Isa Arapaj, Astrit Jaupi etj. Por edhe grupet e studentëve që pasuan kishin një doktor të apasionuar që i niste dhe i priste në pistat e avionëve. Dr Karemani ishte bërë për studentët e pilotimit në Shkollën e Aviacionit një shok, mik e vëlla, një njeri depërtues në shpirtin e pilotëve dhe që ju dhuronte kënaqësi e buzëqeshje për misionin e vështirë të pilotimit ushtarak shqiptar. Doktor Karemani edhe kur Shkolla e Aviacionit u kthye në "Shkollën e Trupës" dhe që shërbeu edhe për helikopterët i përjetoi me ndjenjë ndryshimet që çuan gradualisht deri në eliminimin e shkollës që ishte sa vitale aq edhe domosdoshmëri për kohën. Doktorin e gëzonte çdo sukses dhe ngritje në strukturat ajrore shqiptare, që në fakt në këto vitet e fundit janë në pritje të ringritjes, me qëllim që tradita të mos humbasë dhe të marrë vendin që meriton në zhvillimin teknologjik dhe profesional të vetkontrollit të plotë të hapësirës ajrore shqiptare. Janë një galeri jetësore tipash e karak-

teresh me të cilët është ndeshur në jetë doktor Karemani dhe që vijnë natyrshëm në këtë libër si vlerë e kontribut, profesionalisht i arrirë, plot ndjenjë e mbresa, si pikë referimi për pasardhësit, të pashkëputur nga mjedisi familjar, kulturor, i lidhur fortë me gjen-ealogjinë familjae, fisin, fshatin, krahinën, mbarë trevën e Labërisë. Një libër që shpalos vlera e cilësi, karakteristika, temperamente, traditë, reflektime, triumfe, arsimim, mirësjellje, norma, ligje, përkushtim serioz ndaj detyrës.

Ligji-Betim i Hipokratit i lindur e zotim historik edhe për doktor Karemanin

Doktori nuk e harroi kurrë betimin dhe ndjenjën sublime të detyrës. Fakt është se Betimi i Hipokratit e bëri Kareman Hasko (Aliaj) mjek të pilotave dhe njerëzve të thjeshtë. Njeri me dije të thellura sepse që në shkollë e kishte përvetësuar dhe e dinte mirë se Hipokrati 2500 vjeçar, ishte ai që ndau magjinë nga mjekësia, Hipokrati i epokës së Perikliut, që dijet rreth tij erdhën deri në epokën shqiptare të aviacionit ku shërbeu doktori i kaltërsive, doktor Karemani dhe gjithë kolegët e tij. Kushdo nga doktorët sikurse dhe doktor Karemani e dinte se, babai i mjekësisë konsiderohet një nga figurat më të shquara në historinë e mjekësisë dhe tradicionalisht është quajtur "Babai i Mjekësisë", por ai i dha frymë e jetë

mjekësisë humane, ku humanizmin dhe njerëzillëkun e përqaftuan një plejadë e shkëlqyer mjekësh shqiptarë sikurse edhe doktor Karemani. Doktor Karemani thoshte se "Ecja është ilaçi më i mirë i njeriut", ndërkohë, që "fluturimi është vetëm për ekselentë". Doktorin e dashuroi artin e mjekësisë prandaj edhe u bë më shumë se njerëzor përgjatë jetës e karrierës ushtarako-mjekësore. Për doktor Karemanin ka me dhjetra e qindara mendje e zemra që e kujtojnë për atë çfarë ishte dhe çfarë bënte sepse "Betimi i Hipokratit për të ishte i shenjtë, ishte ligji moral i mjekëve profesionistë", ligji-Betim i Hipokratit i lindur si zotim historik, por që në fakt ishte kthyer në betim të shkruar rreth dy shekuj më vonë, betim që erdhi natyrshëm tek çdo mjek shqiptar. Profesionin e mjekut e bëri doktor Karemanin një njeri profesionist plot virtyte humane dhe që ofronte dashuri njerëzore sikurse kishte mësuar në tre shkolla, branda dhe jashtë vendit. Në aparatet e librit vërtetësia dokumentare e bën monografinë sa solide aq edhe të besueshme në sytë e lexuesit, të miqve, shokëve e kolegëve, çka flet për seriozitetin e shkallës maksimale dhe përkushtimin e autorit Astrit Aliaj. Për këtë arsye mjeku i burrave të kaltërsive, i heronjve të ajrit, do të jetojë përjetësisht në një vepër të të birit dhe në zemër të shokëve, miqve e kolegëve si etalon mirësie.

MBI 100 EFEKTIVË NË MARATONËN E TIRANËS, 3 FITUES

Peleshi: Lëvizja sportive brenda FA, së shpejti me një program të ri entuziast

